

GJUHA E URREJTJES NË MEDIAT AUDIOVIZIVE

Studime dhe analiza të prezantuara në Tryezën e Rrumbullakët,
organizuar nga Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, më 14.11.2018

A GJUHA E URREJTJES SI TEMË GLOBALE

GENTIAN SALA

Kryetar i Autoritetit të Mediave Audiovizive



Gentian Sala

Gjuha e urrejtjes është një temë globale. Duke qenë e tillë është gjithashtu edhe shumë e rëndësishme. Ndaj e përgëzoj Këshillin e Ankesave për këtë iniciativë dhe uroj që konkluzionet apo sugjerimet e kësaj Tryeze Diskutimi të shërbejnë për skanimin e situatës dhe përmirësimin e saj.

Është një dukuri për të cilën diskutohet ditë-ditës, në dritën e zhvillimeve të vullshme teknologjike. Sot diskutohet për raportin e *hate speech* me ligjin, me ligjet për median, me vetë median, internetin dhe rrjetet e shumta sociale. Ndaj së fundi, Parlamenti Evropian ndryshoi Direktivën mbi Shërbimet e Medias Audiovizive. Ç'ka është një pikë e rëndësishme e kësaj

direktive janë shërbimet e shpërndarjes së videove, mediave sociale, videot e krijuara nga vetë përdoruesit, për të cilat kërkohet të përfshihen në Direktivën 2010/13 të BE-së, pasi qartësisht *“kanë ndikim të konsiderueshëm dhe lehtësojnë mundësinë që përdoruesit të formojnë apo ndikojnë në opinionet e përdoruesve të tjerë”*.

Duke lënë mënjanë raportin e gjuhës së urrejtjes me ligjin, pasi shumë vende, përfshirë edhe Shqipërinë, e kanë të sanksionuar në Kod Penal si vepër penale, do doja të theksoja disa momente të raportit të *hate speech* me median në përgjithësi, dhe atë audiovizive në veçanti.

Së pari, më vjen mirë të pohoj se, sa i përket gjuhës së urrejtjes, në Shqipëri situata është larg shumë vendeve të tjera. Madje, edhe në ato raste që e kemi, ose është e importuar siç ishte rasti i fundit në Bularat të Gjirokastrës, ose është e zhvendosur nga mjedise të tjera, më së shumti politike, në mediat audiovizive. Me këtë nuk dua të them se nuk kemi aspak probleme, por të risjell në vëmendje se, në plan ndërkombëtar janë shtuar përpjekjet për të rritur përgjegjësinë profesionale të gazetarëve, si një element kyç në ndikimin që ata kanë në media. Edhe ne duhet t'i bashkohemi kësaj sfide.

Së dyti, veç raportit që përmenda me Kodin Penal, gjuha e urrejtjes është e përfshirë në ligjin për mediat audiovizive, nga rrjedh edhe Kodi i Transmetimit. Ka dy nene në këtë ligj që përcaktojnë në mënyrë rigoroze detyrimet dhe kufizimet për operatorët radio-televizivë; neni 32 dhe 76, sipas të cilëve: *“OSHMA-të nuk transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo forme tjetër diskriminimi”*. Të mirë-përcaktuara këto ndalime i ka edhe Kodi i Transmetimit, “gardian” i të cilit është Këshilli i Ankesave.

Së treti, askush nuk mund t'ia dalë i vetëm, nëse nuk bashkëpunojmë. Ndaj ftoj të gjithë të ulemi e të punojmë bashkërisht sa herë të jetë e nevojshme, jo vetëm për gjuhën e urrejtjes, por dhe problematika të tjera, siç është mbrojtja e fëmijëve, që është gjithashtu një problem global - tek i cili jemi fokusuar edhe ne - apo çështje të etikës e të privatësisë.

Ne ju mirëpresim për çdo bashkëpunim, sugjerim, pse jo, edhe kritika.

ROLI I GAZETARËVE NË PARANDALIMIN E GJUHËS SË URREJTJES NË MEDIAN AUDIOVIZIVE

Dr. LORETA AXHAMI ZELA

Abstrakt

Gjuha e urrejtjes është një ndër sfidat me të cilat po përballet media sot, krahas atyre të karakterit financiar, menaxherial, teknologjik etj. Edhe pse me ndikim të madh në shoqëri, në vend mungojnë të dhënat ose raportet periodike në lidhje me këtë fenomen. Prandaj, qëllimi i këtij studimi është të ofrojë informacion të detajuar mbi njohuritë dhe perceptimet e gazetarëve, si dhe të evidentojë faktorët që ndikojnë në shfaqjen e gjuhës së urrejtjes në median shqiptare. Për realizimin e studimit jemi mbështetur në të dhëna empirike sasiore dhe cilësore të përfthuara nga anketat dhe intervistat me gazetarë, redaktorë përgjegjës, kryeredaktorë të mediave audiovizive në vend, si kombëtare dhe lokale. Gjithashtu, në këtë studim do të paraqiten disa praktika pozitive të aplikuara në vendet e tjera, të cilat mund të shërbejnë si strategji për parandalimin dhe minimizimin e gjuhës së urrejtjes në median audiovizive.

Fjalët kyçe: *Gjuha e urrejtjes, sfida, praktika, media.*

A GJUHA E URREJTJES DHE PROFESIONALIZMI I GAZETARËVE



Loreta Axhami Zela

Studime të ndryshme listojnë një sërë faktorësh, që kanë ndikuar në zhvillimin dhe prezencën e shtuar të gjuhës së urrejtjes, si në median tradicionale, edhe në atë të re. Si faktorë kryesorë analizuar në nivel makro veçohen: krizat financiare, paqëndrueshmëria dhe progresi i ngadaltë ekonomik, i shoqëruar me rritje të normave të papunësisë, të cilat kanë çuar në trazira shoqërore dhe rritje të racizmit, ksenofobisë dhe diskriminimit ndaj grupeve të ndryshme në të gjithë botën. Ndërsa në nivel mikro janë zhvillimet në industrinë e medias, të tilla si: avancimi teknologjik, marrëdhëniet e reja të mediave me audiencat, vështirësitë financiare, mungesa e investimeve të duhura në burime njerëzore (specializime

dhe trajnime për reporterët, gazetarët etj.).


Ndërkaq, në kushtet e shpërthimit të informacionit (ose infoobezitetit) roli i gazetarëve si filtër mbrojtës ndaj shfaqjes së gjuhës së urrejtjes në media rritet. I. Ramonet flet për nevojën e të ashtuquajturës “ekologji të informacionit”, pasi për shkak të shpërthimit, të mbingopjes së vet, informacioni është infektuar në kuptimin e parë të fjalës, i helmuar prej lloj-lloj gënjeshtresh, i ndotur me thashethemnaja, me shtrembërime, me keqinterpretime dhe manipulime.¹ Ndërsa R.C.Almagor (2008)², në esenë me titull “Limitet e raportimit objektiv”, vë në pikëpyetje aksiomën se raportimi objektiv është raportim i mirë dhe etik. Duke analizuar kontradiktat dhe paradokset në marrëdhëniet ndërmjet objektivitetit dhe etikës në raportim, Almagor thekson se mbulimi objektiv/

1 Ignacio Ramonet: ‘Shpërthimi i gazetarisë, nga media e masave të masave të mediave’, Zenit Editions, 2018

2 Raphael Cohen-Almagor: ‘The limits of objective reporting’ Journal of Language & Politics, 2008

neutral i gjuhës së urrejtjes në media jo gjithmonë lidhet me profesionalizmin. Sipas tij, subjektiviteti duhet të prevalojë mbi objektivitetin kur media mbulon çështje apo fenomene antidemokratike, siç është edhe gjuha e urrejtjes. Përveç kësaj, teknologjia e ka bërë gazetarinë gjithnjë e më e shpejtë, ku objektivi është aktualiteti sa më i madh, gjë që sjell pasoja mbi cilësinë e informacionit. Gazetarët kanë gjithmonë e më pak kohë për përpunimin dhe analizën e thellë të materialit.³ Në këto kushte, ajo çka nevojitet është ndërgjegjësimi dhe edukimi i gazetarëve mbi gjuhën e urrejtjes dhe pasojat në shoqëri, si një hallkë e rëndësishme në kufizimin e fenomenit.

Grafik nr.1: Prirjet e shfaqjes së gjuhës së urrejtjes në median audiovizive, 2018



Media shqiptare reflekton thuajse të gjitha problematikat e lartpërmendura. Pozitiv është fakti që për shumicën e gazetarëve të medias audiovizive, gjuha e urrejtjes nuk është fenomen i panjohur.⁴ Nga gazetarët e anketuar, 36% e tyre shprehen se kanë shumë njohuri mbi gjuhën e urrejtjes, 28% pak dhe 36 % disa njohuri, ndonëse më shumë se gjysma e tyre nuk janë në gjendje të japin një përkufizim. Megjithatë, vlen të theksohet se ende nuk ka një përkufizim të gjithëpranuar nga studiuesit se çfarë është gjuha e urrejtjes, ndërsa universiteti është burimi kryesor i njohurive të gazetarëve mbi gjuhën e urrejtjes; vetëm 22% e të anketuarve shprehen se njohuritë i kanë marrë në median ku punojnë dhe 19% në trajnime të ndryshme.


3 Stephan Russmohl: 'Gazetaria', K&B, 2010

4 Të dhënat e paraqitura në këtë studim janë rezultat i anketave të realizuara me 50 gazetarë, redaktorë e kryeredaktorë të mediave audiovizive : Tv Klan, TCH, News 24, Ora News, Top News, ABC News, Klan +, etj.. Anketimi është bërë gjatë muajit shtator 2018, me ndihmën e studentëve të departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit, UT, Elsa Kallanxhiu dhe Renaldo Salianji.

Përsa i përket punës së përditshme në redaksitë e tyre, vetëm 14% e gazetarëve shprehen se i kushtohet shumë rëndësi gjuhës së urrejtjes në median ku punojnë, një shifër e ulët kjo, ndërsa 67% vlerësojnë se nuk i kushtohet aspak ose shumë pak rëndësi.

Domethënës është fakti që gjysma e të anketuarve shprehen se ka një rritje të gjuhës së urrejtjes në median audiovizive, ndërsa vetëm 11% mendojnë të kundërtën (shih. Grafikun nr.1).

Grafik nr.2: Kategoritë ku shfaqet më shumë gjuha e urrejtjes në median audiovizive, 2018



Informacioni i thelluar (biseda në studio, talk show, komente, opinione, etj.) është kategoria ku shfaqet më shumë gjuha e urrejtjes në median audiovizive dhe që transmetohet kryesisht në fashën orare në *prime time*, kohë kur audienca është më e madhe (shih Grafikun nr.2).


Gjithashu, vlen të theksohet se në këtë kategori ka shpërpjestime të mëdha përsa i përket mbulimit të sektorëve, konkretisht vërehet mbimbullim i politikës ndërsa fusha të tjera, si ekonomi, sociale, kultura janë të nënraportuara. Sipas gazetarëve të intervistuar është politika ajo që prodhon më shumë gjuhë urrejtjeje në media, por ky fakt nuk përjashton rolin e gazetarëve për të qenë më të vëmendshëm dhe selektiv në informacion pavarësisht burimit.

Për 75% të gazetarëve të anketuar, faktorët kryesorë që ndikojnë në shfaqjen

e gjuhës së urrëjtjes janë mungesa e investimeve në burimet njerëzore të medias, konkretisht mungesa e trajnimeve dhe kualifikimeve të vazhdueshme, si dhe vështirësitë financiare me të cilat përballet media sot.

Shumë redaksi në përpjekje për të reduktuar shpenzimet kanë zvogëluar numrin e gazetarëve ndërsa volumi i punës është rritur (shih Grafikun nr.3).

Grafik nr.3: Faktorët që ndikojnë në shfaqjen e gjuhës së urrëjtjes në median audiovizive, 2018



Përfundime

-Politika prodhon më shumë gjuhë urrëjtje në media, por ky fakt nuk përjashton rolin e gazetarëve si një halkë e rëndësishme në parandalimin dhe kufizimin e shfaqjes së këtij fenomeni. Gazetarët duhet të jenë më të vëmendshëm dhe selektiv në informacionin që përçojnë, pavarësisht burimit.

-Për të frenuar gjuhën e urrëjtjes nevojitet ngritja dhe funksionimi i bordeve të etikës si një instrument vetërregullues i medias.

-Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit të gazetarëve nëpërmjet trajnimeve të ndryshme shfaqet si domosdoshmëri.

-Gjithashtu, kërkohet përmirësimi i mëtejshëm i kurrikulës mësimore në universitet në lëndët që trajtojnë këtë dukuri, si psh. tek Etika e medias (module të veçanta) etj. si reflektim i ndryshimeve të shpejta në mjedisin mediatik.

-Krahas rritjes së ndërgjegjësimit të gazetarëve nevojitet zhvillimi i studimeve të mëtejshme, ku fokusi të mos jetë vetëm tek gazetarët, por edhe tek audiencat në kushtet kur ka një rritje të interaktivitetit mes medias dhe audiencës.

REALITETI I MEDIAVE AUDIOVIZUALE DHE GJUHA E URREJTJES

Prof Asoc. Dr. BASHKIM GJERGJI

Abstrakt

Në kushtet kur tradita flet për harmoni fetare në vend, për mbrojtje të hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore, për mungesë aktesh agresive, dhune ndaj popujve të tjerë, apo grupimeve me tipare psiko-kulturore të ndryshme, termi “gjuhë e urrejtjes” në këtë rast mund të thuhet se nuk përkon me kuptimin që i kanë dhënë shkencat sociale, bazuar në faktet historike dhe përplasjet e shumta, nisur nga antikiteti e deri në ditët e sotme.

Por në një farë mënyre, ajo mund të konsiderohet si një derivat i asaj që preferojmë ta quajmë gjuhë me përmbajtje të theksuar tensionale dhe, që në mediat tona audiovizuale, haset më dendur e në mënyrë periodike në debatet kryesisht televizive, veçanërisht në periudhat e fushatave elektorale. Kjo lloj gjuhe nxit një tension të përgjithshëm në shoqëri, që vjen e artikullohet në bisedat e kafeneve, apo në ambiente të ndryshme, ku përplasjet mes palëve konkretizohen nga frazat, toni, argumentet e përdorura. Kjo nuk do të thotë se mungojnë ato fragmente audiencash që, falë nivelit, mund të kalojnë në filtrat e tyre përmbajtjen e mediumeve të ndryshme. Kjo panoramë bëhet disi më e komplikuar me mediat e reja, ku anonimati, falë mundësive për të pasur shtypin, radion apo TV-në e vet (sikurse thotë studiuesi francez Eric Scherer), ndihet i lirë për të shkelur privatësinë e tjetrit, për të denigruar, fyer apo përdorur shprehje banale, kërcënuese, që bien në kundërshtim me sistemin tradicional të vlerave.

Përdorimi pas viteve '90 i emërtimeve me ngjyrim të fortë pezhorativ “çeçen”, “malok”, “prostituata” etj. mund të konsiderohen deri diku edhe si pasoja të trajtimit të problematikave, rajoneve e grupeve të ndryshme në vend nga media. Po kështu, modeli i transmetimeve të produkteve kinematografike komerciale, ku ndeshja e individëve, bandave, si dhe stereotipet në lidhje me popullsi të ndryshme, që shfaqen me intensitet dhe brenda kornizave të zakonshme artistike, besoj se lënë gjurmë, veçanërisht në kategori të caktuara pa përvojë jetësore dhe, po ashtu, pa një sfond formimi solid.

Nëse pajtohemi se me rëndësi është jo thjesht renditja e fakteve si argument, por një këndvështrim i fokusuar në shkaqet e kësaj gjendjeje dhe reagimet e audiencave të ndryshme ndaj gjuhës së urrejtjes (filmat) apo gjuhës tensionale plot sharje e fyerje (TV), atëherë do ta konsideronim logjike rishikimin e legjislacionit dhe përgatitjen e sugjerimeve përkatëse, një evidentim kronik nga ana e AMA-s në medime të ndryshme (nëse është e mundur) dhe gjetja e rrugëve për nxitjen e debatit me karakter etik brenda redaksive prodhuese.

Fjalë kyçe: *gjuha e urrejtjes, debat, medime, liria e fjalës*



Bashkim Gjergji

Një takim si ky i sotmi, me tematikë të fokusuar në gjuhën e urrejtjes, vjen pikërisht në kohën kur në atmosferën e përgjithshme të zhvillimeve mediatike, sidomos me daljen në skenë të mediave të reja, dukuria e saj gjen vend në përmbajtje të ndryshme të ofruara së pari, si një element jo thjesht gjuhësor, por si shprehje e një konstrukti mendor që ka zënë vend e, në kushte të veçanta, nxitet, mbahet gjallë dhe, së dyti, si i tillë influencon drejtpërdrejtë në ruajtjen e një temperature të lartë shoqërore, brenda së cilës shohim të lexojmë çdo ditë komente fyese, dëgjojmë debate me tone të ashpra që zëvendësojnë shkëmbimin e argumenteve dhe aktet e dhunës që mbushin kronikën e zezë. Shkurt, kemi

një vërshim “të luftës” verbale, e rënduar në një masë të konsiderueshme, aspak e nevojshme mendoj për një shoqëri të tronditur thellë nga e shkuara diktatoriale, të lodhur nga një tranzicion i gjatë dhe problematik, të stresuar nga vështirësitë jo të pakta për përbalimin e të përditshmes dhe të ekspozuar ndaj dilemave që rrjedhin, si pasojë e ndryshimit të sistemit të vlerave morale në kushtet e një demokracie ende të brishtë.

Mirëpo në trajtimin e çështjes, që merr në shqyrtim kjo tryezë diskutimesh, dua të flas pak lidhur me termin, sigurisht pa dashur të kaloj në një plan thjesht teorik, por me një pikësynim të qartë sa i përket realitetit tonë edhe në këtë pikë. Sikurse njihet, historia njerëzore ka qenë gjithnjë, veç të tjerash, edhe një lumë i vazhdueshëm gjaku, për shkak të politikave, ekspansionit ushtarak dhe kushteve të mbijetesës deri në kohët e reja, kur dukuria në fjalë nuk zhbehet, por ushqehet nga një sërë ngjarjesh që kanë shenjuar periudha të caktuara historike. Në sfondin e tyre, shprehja “hate speech” (gjuhë e urrejtjes) ka ardhur si produkt i shfaqjes së dhunës së ushtruar ndaj grupeve apo personave brenda një hapësire të caktuar jetese të përbashkët, mbi bazën e tipareve të tilla, si raca, religjioni, origjina etnike, nacionale, seksi, gjymtimet fizike etj.

Dallimi racial në SHBA, holokausti në periudhën e Luftës së Dytë Botërore, represioni serb mbi popullsinë shqiptare të Kosovës, që kulmuan në vitet 1998-1999, si dhe konfliktet e shfaqura prej përfundimit të saj e deri më sot, si shembuj për çka theksova më lart, e kanë nxitur, e kanë mbajtur gjallë gjuhën e urrejtjes. Përdorimi i saj, ekzistenca e psikozave fyese, nënvleftësuese për komunitete, grupime a individë dhe kalimi në akte dhune nuk e kanë lënë në hije retorikën për të drejtën e shprehjes, por përkundrazi e kanë orientuar më fort me kohë, si studimin e fenomenit, ashtu edhe ndërmarrjen e masave parandaluese drejt asaj që konsiderohet lidhje e drejtpërdrejtë e fjalës, e deklamimeve agresive me aktet e dhunës. Ca më tepër sot, kur kjo lloj gjuhe përdoret si “argument” justifikues për veprime agresive, terroriste në shkallë të gjerë e me pasoja të rënda. Ndaj nuk është e rastit që një pjesë e konsiderueshme e vendeve të botës, si Kanadaja, Gjermania, Franca, Britania e Madhe, India, Afrika e Jugut e shumë të tjera, bazuar në arsyetimin shkak-pasojë, dënimin e gjuhës së urrejtjes e kanë pjesë të legjislacionit të tyre. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, në nenin e saj të 20-të, u kërkon shteteve aderuese në të “të ndalojnë çdo favorizim të urrejtjes kombëtare, asaj raciale, fetare, që çojnë në diskriminim, dhunë, armiqësi”.

Kodi ynë Penal ka dispozita të veçanta kushtuar gjuhës së urrejtjes, të zbatueshme njëlloj për të gjithë qytetarët, pra edhe për njerëzit e medias. Neni 265 i tij thekson shprehimisht: “Nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve, për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja, me qëllim përhapjen e shkrimeve me përmbajtje të tilla, e kryer me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet”. Ndërkaq, duhet theksuar se liria e fjalës nuk bie ndesh me sistemin ligjor, me çështjen e mbrojtjes së ligjeve. Kur ligja apo një ndjekje penale nuk japin shpjegime të argumentuara se ku qëndron “nxitja nga fjalët e artikuluar publikisht apo nga përmbajtjet e hedhura në qarkullim”, vetëm atëherë mund të thuhet se i është hapur rruga shkeljes flagrante të të drejtave të njeriut.

E konsiderova të nevojshëm këtë lloj parashtrimi, pasi mendoj se është me vend për të theksuar se në përgjithësi opinioni ynë publik nuk mban mbi supe plagën e urrejtjes e të dhunës ndaj popujve të tjerë, ndërkohë që mendoj se opinione të caktuara ndaj grupeve të marginalizuara (fjala vjen romëve etj.) edhe nëse kanë ekzistuar me kohë, sikurse edhe sot, nuk kanë qenë në atë shkallë sa të nxisnin veprime masive dhune dhe të shndërroheshin në një aspekt kurdoherë të pranishëm në jetën sociale të vendit. Edhe njëherë: kjo që pohoj këtu nuk do të thotë se përjashtohen tërësisht individët apo grupime që mund të kenë paragjykime nënvleftësuese për kategori të caktuara, por nuk mendoj se këto janë shndërruar në atmosferë të përgjithshme përbuzëse

dhe ca më tepër agresive, duke mbajtur kështu situata të ndezura tensionale, sikurse vihen re gjetkë edhe në shekullin e 21-të.

Megjithatë, rastet e veçuara të pas 1990-s në shtypin e shkruar dhe në transmetimet e RTSH apo kanaleve private televizive në vitet 2000, si dhe kontaktet e gjera me forume e organizata mediatike ndërkombëtare, besoj se kanë influencuar në hartimin e kodeve etike, ku shprehimisht gjuha e urrejtjes është cilësuar e papranueshme dhe e dënueshme nga aspekti i etikës profesionale. Konkretisht, kodi më i ri i 2018-s thekson: “Media duhet të mos botojë materiale që nxisin urrejtje apo dhunë ndaj individëve mbi bazën e racës, fesë, kombësisë, ngjyrës, origjinës etnike, anëtarësisë, gjinisë, orientimit seksual, statusit civil, paaftësisë, sëmundjes apo moshës... Ky parim plotësohet më tej më në detaje me përcaktimet e tjera lidhur me ndërhyrjet në jetën private, nxitjen e krimit e dhunës apo me mbrojtjen e fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara”. (ISHM, Kodi i Etikës së Gazetarit, 2018)

Pavarësisht faktit se sa influente janë kodet në punën e përditshme të stafëve redaksionale dhe ç’rrugë duhet të ndiqet për rritjen e efikasitetit të tyre në praktikë, në optikën time, mediat tona audiovizive kanë ditur ta shmangin gjuhën e urrejtjes, që fare natyrshëm nxit krimin, dhunën, kurse rastet e veçuara që përmenda më sipër, janë të kufizuara, sporadike dhe jo vazhdimësi e qëllimshme e shndërruar në një linjë editoriale. Madje, shembuj të tillë kur moderatori shprehet “po flet malokçe”, ose pasi mbaron intervista me dy sportistë të rinj të huaj, me ngjyrë, drejtuesja shton në fund: “për të gjithë ju që mendoni se këtu vjen erë, ju siguroj që jo”, etj etj. (nuk kam marrë përsipër të bëj një etnografi të transmetimeve tona duke rreshtuar fakte), mendoj se këto janë pasqyrim i mangësive profesionale, i moskujdesit, i nxitimit (lapsuse!) apo i manisë për t’i dhënë një liri të tepruar rolit personal si moderator.

Ndjekja e një seri emisionesh televizive dhe pasqyrimi paralel në shtypin e shkruar na servirin shpesh e më shpesh një panoramë mediatike, ku dallohet qartë një gjuhë tensionale, në sfondin e së cilës përdoren shprehje, fjalë me natyrë fyese që u adresohen individëve të caktuar, pjesëmarrës në këto hapësira publike dhe kanë për bazë pozicionet e kundërta kryesisht politike. Kjo pjesë, gati e përnatshme, plotësohet më tej me tensionin që përcjellin kronikat e zeza, apo komentet pasuese si pjesë e storytelling, sikurse ndodhi në rastin e fundit, kur pas lajmit rreth asaj çka ndodhi në Bularat, vazhdimi në ekran ofron shfaqjen e parrullës: “një grek më pak”. Po e theksoj sërish, nëse nuk shoh që të kemi një instalim të gjuhës së urrejtjes me pasojë të drejtpërdrejtë veprime dhune, agresive, mendoj se kemi një gjuhë dhe imazhe që mbajnë ndezur tensionin social, si “paradhomë” për të kaluar më pas, në

kushte të caktuara, në gjuhën e urrejtjes. Po në këtë kuadër shoh gjithashtu ciklin e pambarimtë të produkteve kinematografike, ku gjuha e urrejtjes dhe shprehjet banale, krimi dhe dhuna ekstreme, psikologjike dhe fizike, ofrojnë modele sjelljeje dhe nuk mund të pohohet kategorikisht se janë pa ndikim.

Duke iu kthyer edhe njëherë debatit televiziv, si një katalizator i klimës së ndezur shoqërore, dua të tërheq vëmendjen në faktin, ndoshta të konstatuar gjerësisht, se “argumentet”, fjalët e përdorura dhe fryma e debateve plot kundërshti, zë të lartë dhe sharje bëhet pjesë e fjalorit të konsumatorëve mediatikë, që në mungesë të filtrave personale për shkak formimi (dhe jo vetëm) i konsiderojnë ato si instrumente diskutimi në tryezën e kafes apo në çdo rast tjetër, ku u takon të jenë të pranishëm!

Me këtë rast dua t’u prezantoj një fakt shumë domethënës: auditorët e kurseve mbi gazetarinë dhe shkencat e komunikimit në degën e publikut këtu në Tiranë, por dhe në institucionet e arsimit të lartë privat, në Shqipëri, në Kosovë e Maqedoni, reflektojnë thuajse në të njëjtën mënyrë mendimin e studentëve të angazhuar në studime, por dhe në vëzhgime të pjesshme në funksion të detyrimeve që kanë, se mediat e sotme transmetuese përcjellin një atmosferë të ndezur përmes reagimeve të ashpra, “kacafytjes së pjesëmarrësve” që aktrojnë sipas dirigjimit të moderatorit, i cili nga ana e vet, sikurse vë në dukje Pier Bourdie në studimin e tij “Mbi Televizionin”, e orienton strukturën përmbajtësore të emisionit drejt zënkave, fyerjeve, shpërthimit të shpenguar të pjesëmarrësve, që në këtë rast, për të, shërbejnë si aktorë që sigurojnë audiencë.

Duke folur për dukuritë e mësipërme të medias klasike e gjej me vend të theksoj se, për shkak të zhvillimeve teknologjike, pozicioni i tyre në hierarkinë mediatike është vënë në vështirësi, sikurse pohon studiuesi amerikan Joseph Dominick, por ato nuk kanë “vdekur”. Me këtë kam parasysh atë kategori individësh që, ose e kanë të vështirë t’u adaptohen mediave të reja për t’u informuar, ose nuk i përballojnë dot pagesat që kërkon ky lloj konsumi, ose thjesht janë familjarizuar me vite me mediat klasike, ku shohin pasqyrimin e bindjeve a opinioneve personale dhe kanë një marrëdhënie parasociale me gazetarë të caktuar. Pa përfjashtuar këtu edhe faktin se, sipas disa sondazheve të raportuara në botime të Institutit Shqiptar të Medias, shumë priren t’u referohen mediave tradicionale për informacion të besueshëm. Më i fundit prej sondazheve, ai i vitit 2014, evidenton se 73 për qind e të anketuarve besonin informacionin televiziv, përkundrajt 46 për qind të atyre që u referohen mediave online. Është për këtë arsye pse përmbajtja e mediave klasike, e prezantuar në linjën e *gjuhës tensionale*, mund dhe duhet të jetë

objekt vëzhgimi dhe diskutimi me pikësynim shmangien sa më shumë të jetë e mundur e asaj, çka do t'i shërbente përforsimit “të pushtetit të argumentit” në hapësirën publike. Ndaj mendoj se është i papranueshëm komenti i lansuar këto ditë në një nga gazetatat e ditës edhe në sajtin e saj online ku, ndërsa bëhen përpjekje për të dhënë një gjykim për situatën e konfliktit më të fundit institucional, shkruhet: “Nuk do ta konsideroja problem shprehjen e inatit në fjalimet e tyre parlamentare, në diskutimet, në opinionet e shumta ‘alla shqiptarçe’, në fjalorin e tyre ndaj kundërshtarit. Tashmë jemi mësuar me këtë inat gati-gati fëmënor që shfaqet çdo ditë në ekranet tona”. Kjo do të thotë të pranohet hapur tolerimi apo depozitimi i një situatë të nderur e të mbarsur me tone të larta kundërshtish dhe inate, çka imponon një qasje emocionale negative.

Mirëpo duke pohuar se, referuar termit “gjuhë urrejtjeje” si produkt ngjarjesh e konfliktesh shumëvjeçare e me pasoja në periudha të caktuara, kjo dukuri nuk shfaqet si tipar i qenësishëm në mjedisin e sotëm të medias tradicionale, në këtë përfundim nuk mund të mbërrij kur flitet për mediat e reja, ku gjurmët e saj të vazhdueshme e me profile të qarta përmbajtësore çajnë përmes portaleve, që ndiqen jo pak nga rrethet e gjera të interesuarish, disa prej tyre për informacion, të tjerë për argëtim dhe shumë pse e kanë më të lehtë operimin me një smartphon, sesa të lidhen pas ekranit, e ca më pak me shtypin e shkruar. Sipas botimit në këtë vit të “Peizazh-it të Medias Online në Shqipëri” nga Instituti Shqiptar i Medias, në vend veprojnë 120 portale, ku gjen të angazhuar një pjesë të konsiderueshme të gazetarëve të njohur, krahas shumë emrave të tjerë, një fenomen ky që në raportin e përpiluar komentohet si migrim dixhital.

Vështirësitë e mediave tradicionale në përballje me evolucionin e vullshëm teknologjik, nga njëra anë, dhe kostot e ulëta, si dhe shkalla më e madhe e pavarësisë editoriale në portalet e shfaqura arsyetojnë këtë prirje në zhvillim e sipër. Ajo që bie në sy dhe që ndoshta dhe të tjerë e kanë vënë në dukje, është se reagimet e publikuara ndaj përmbatjeve të hartuara për portalet në fjalë janë në përgjithësi një shpërthim shprehjesh agresive, plot banalitete, shpesh duke shpërfillur fakte, duke denigruar individë apo duke cenuar jetë private.

Dhe jo rrallë po shihet ritransmetimi a ripublikimi i njoftimeve të pabazuara, ose siç thuhet tashmë fake news, ku spikasin sharjet, fyerjet dhe interpretime të pambështetura në fakte, ose më saktë të orientuara sipas interesit të njerit apo tjetrit nga një sërë mediash, që në kundërshtim me standardet e njohura profesionale kanë flakur tej parimin e verifikimit të informacioneve

të tilla përmes burimeve serioze, ose janë të detyruara të veprojnë në këtë mënyrë pse mund të kenë humbur pavarësinë e tyre redaksionale dhe bëjnë çka u diktohet. Kjo panoramë merr nuanca më të zymta po të merret parasysh ajo shkallë ndikimi aktual që është pasojë e faktit që studiues të shumtë, si Sonja Livingston, Elihu Katz etj. kanë shpjeguar me kohë se interaktiviteti i “konsumatorëve medialë/qytetarëve me mediat e reja, nuk është dytësor apo opsional; ai është thelbi i mediave të reja. Jashtë interaktivitetit nuk mund të kuptohet asgjë, nuk ka një dhënës dhe marrës në kuptimin klasik, pasi rolet e produksionit dhe konsumatorit janë të konvertueshëm. (*Livingstone, Sonia 2008, Engaging with media - a matter of literacy?*)

Nga një kontroll, sidoqë jo sistematik, i përmbajtjeve që hasen në portale, nuk është e vështirë të konstatohet gjuha e urrejtjes, që falë anonimatit dhe mungesës së rregullave ligjore të detyrueshme për to, ka marrë përmasa të mëdha. Frazat dhe paragrafët e saj të rëndë konturohen rreth tri aspekteve kryesore, që përbëjnë thelbin e artikujve, editorialeve të publikuar. Dhe këto janë Nacionalizmi, Politika dhe Religjoni. Por nuk mungojnë edhe komentet e ngarkuara me gjuhën e urrejtjes rreth grupeve të marginalizuara apo individëve të veçantë, të cilët bëhen objekt i vëzhgimeve dhe publikimeve të blogerëve të paguar. Evidentimi i këtyre mentaliteteve dhe interpretimeve online na japin të kuptojmë se, përtej klishesë të harmonisë fetare, traditave tona fisnike të mikpritjes, ndihmës reciproke, besës etj etj., që natyrisht janë në karakterin, në natyrën psiko-kulturore të popullit tonë, mes nesh ekzistojnë edhe individë apo grupime të kufizuar, prirja e të cilëve në diskutimet e gjera publike, nën mantelin e anonimatit që ua mundëson teknologjia e sotme, është goditja përmes gjuhës së urrejtjes, helmimit të hapësirës publike. Këta përballen jo duke i detyruar thjesht të heshtin dhe duke besuar ndërkohë se kjo kategori nuk ekziston, por me anë të përgjigjeve plot argumente, të vërtetave të verifikueshme dhe respektimit të dinjitetit njerëzor. Sigurisht, kur bëhet fjala për shprehje opinionesh, që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë e të menjëhershme me akte dhune, ndryshe në veprim duhet të hyjë ligji.

Një angazhim ndaj situatës që Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) me të drejtë e bën objekt të kësaj tryeze rrjedh, besoj, prej bindjes se mediat tona të reja nuk janë të imunizuara nga ato dukuri që po shqetësojnë opinionin publik, studiuesit dhe qendra vendimmarrëse në shkallë globale. Kështu interpretimi i Pierre Haskit, i publikuar së fundmi në shtypin e shkruar, se besimi që ngjalli në fillim interneti është “elementi që më shumë se çdo tjetër është humbur në botën online... Idealizmi i etërve themelues i ka lënë gradualisht rrugë urrejtjes, manipuluesve, rrezikut të konflikteve të reja dhe sulmeve të hacker-ëve” është në rezonancë me shqetësimin dhe diskutimin në sfondin e zhvillimeve mediatike aktuale në vend.

A ka mundësi ndërhyrjeje me qëllim shmangien e dukurive negative? Përderisa përpjekje dhe modele aplikimesh të masave preventive po shfaqen në nivel ndërkombëtar, mendoj se edhe këtu mund të ndërmerren iniciativa parandaluese. Nëse dispozita ligjore ekziston, atëherë tryeza e debatit në të ardhmen duhet të zgjerohet nga pjesëmarrja edhe e njerëzve të ligjit dhe të komisionit parlamentar të medias (po të jetë e mundur) dhe të fokusohet në çështjen e zbatimit të tij në praktikë. Pa dashur të bëj historinë e institucionit, dua të theksoj se AMA është më e pranishme në media, më transparente dhe aktive, por do të sugjeroja që monitorimet e saj të vazhdueshme të shndërrohen në botime qarkulluese në të gjitha mediumet ekzistuese, krahas organizimit të takimeve të tilla me tema të tjera specifike, si dhe inicimit, nëse shihet e arsyeshme, e një emisioni të përdyjavshëm a të përmuajshëm në kanalin publik (ndoshta), me ekspertë të medias, pedagogë, studentë e, padyshim, gazetarë aktivë për të diskutuar mbi dukuritë në kundërshtim me standardet profesionale të shfaqura ndërkohë në transmetimet klasike dhe online.

Si rrugë tjetër me rëndësi shoh edukimin e brezave përmes programeve të shkollës së mesme. Në një nga botimet e Institutit Shqiptar të Medias, dy autorë të njohur amerikanë (Kovach e Rosenstiel), të shqetësuar për qarkullimin e fake news-eve, mungesën e verifikimit e një sërë dukurish të tjera, ngrenë çështjen e edukimit mediatik, që do të nxiste qasjen skeptike ndaj produktit mediatik të ofruar nga çfarëdo lloj mediumi. Një drejtim edukimi me dy elemente bazë: peizazhin aktual mediatik dhe si duhet “lexuar” (përdorur), dhe etikën si një perceptim i gjerë moral në lidhje me shoqërinë, politikën, biznesin dhe median, do të ishte mendoj një strategji edukimi e drejtë dhe e nevojshme, madje jo vetëm për mënyrën se si duhet kuptuar e përdorur media, por edhe më gjërë.

Së fundi, po quaj me vend të përmend se shpesh theksohet gjendja problematike ekonomike e mediumeve si shkak dukurish negative të shfaqura në krejt rrjedhën e zhvillimeve të tyre në periudhën e pas vitit 1992. Duke u pajtuar pjesërisht me këtë konstatim, mendoj se sistemi ynë mediatik do të mund të pësojë përmirësim, si në kuadër të rritjes ekonomike të vendit, por po ashtu edhe përmes sigurimit të një kualiteti të ri, më të lartë të punës së stafeve redaksionale, që pikërisht si e tillë do të sjellë për pasojë më shumë klikime, më shumë audienca, të cilat, nga ana e tyre, do të vlerësonin dhe besonin në seriozitetin, korrektësinë, saktësinë, qartësinë, respektin e medias për publikun e gjerë, që e sheh atë si burim informimi dhe ndërgjegjësimi.

STEREOTIPET ME BAZË GJINORE NË TELEVISIONET LOKALE. SFIDAT E PËRBALLJES ME KODIN E TRANSMETIMIT

Phd. Doktor SUELA MUSTA

Abstrakt

Stereotipet me bazë gjinore përbëjnë ndër cenimet më të shpeshta të etikës së informacionit dhe komunikimit në media. Si përkufizime stilistike, stereotipet që lidhen me gratë dhe vajzat, kanë ndikim të drejtpërdrejtë në formulimin e opinionit e publikut, veçanërisht kur ato përdoren në medime masive sikurse është televizioni. Ekranin mban ende supremacinë e informimit dhe edukimit publik dhe, posaçërisht, ky efekt i magjisë televizive, ndihet më së shumti në komunitetet lokale.

Punimi fokusohet në pasqyrimin mediatik të ngjarjeve që përfshijnë gra dhe vajza, në disa televizione lokale. Monitorimi dhe analiza e gjuhës së informacionit të kronikave nxjerr në pah raportet komplekse që gazetarët (gra dhe burra) kanë me mendësinë gjinore, me marrëdhëniet burrë-grua në shoqëri, duke e pasqyruar realitetin, përmes stereotipeve.

De jure, fenomeni i stereotipeve përballët me norma dhe sanksione, të parashikuar nga Kodi i Transmetimit, që buron prej ligjit “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Normimi që parashikon ndalimin e këtij fenomeni dhe të tjerë që lidhen me diskriminimin dhe gjuhën e urrejtjes përmbledhen tek nenet e Kodit, i cili orienton qartë mediat audiovizive në transmetimet e tyre për të respektuar të drejtat e njeriut.

Por a zbatohen de facto rregullat e parashikuara në Kod dhe në çfarë sfidash përballen gazetarët në terren dhe në mjediset e televizioneve lokale? Si duhen përshtatur në mënyrë sa më efikase për mediat audiovizive lokale, normat e Kodit të Transmetimit dhe cilat duhet të jenë rrugët që duhen ndjekur për respektimin e Kodit? Përgjigjet e gazetarëve, qasjet teorike, ekspertiza mediatike për minimizimin e stereotipeve dhe nevoja për të integruar në punën e medias, Treguesit e ndjeshmërisë gjinore, një Udhëzues ndërkombëtar, hartuar nga UNESCO, janë drejtimet e përmbajtjes së këtij punimi studimor.

Termat kyçe: Stereotipet gjinore, Kodi i Transmetimit, etika e komunikimit dhe informacionit, media audiovizive, televizionet lokale

Stereotipet me bazë gjinore përbëjnë ndër shkeljet më flagrante të etikës së informacionit dhe komunikimit në media. Si përkufizime stilistike gjuhësore, stereotipet që lidhen me gratë dhe vajzat, të përdorura në medime masive sikurse është televizioni, kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ngritjen e një opinioni të caktuar publik lidhur me statusin dhe të drejtat e grave.

Ekrani televiziv, edhe pse në konkurrencë të ashpër me magjinë e internetit mban ende supremacinë e informimit dhe edukimit publik, dhe kjo ndihet më së shumti në komunitetet lokale.



Televizioni, sipas studiuesve të komunikimit dhe shkencave sociale, duke vënë në pah elementë të semantikës me përmbajtje paragjyquese ndikon drejtpërsëdrejti në sjellje dhe vlerësime të ndryshme sociale. Sipas kërkimeve shkencore, stereotipet dhe diskriminimet mes dy gjinive në përmbajtjet mediatike kanë ardhur duke u shtuar e, për rrjedhojë, edhe impaktet e këtyre modeleve në shoqëri paraqesin rrezik në rritje.

Analiza e gjuhës së informacionit të disa kronikave televizive nxjerr në pah raportet komplekse që gazetarët (gra dhe burra) kanë me mendësinë gjinore, me marrëdhëniet burrë-grua në shoqëri, duke e përcjellë realitetin shpesh edhe përmes stereotipeve.

De juro, fenomeni i stereotipeve përballlet me norma dhe sanksione, të parashikuar nga Kodi i Transmetimit, që buron prej ligjit për transmetimet audiovizive. Normimi që parashikon ndalimin e këtij fenomeni dhe të tjerë që lidhen me diskriminimin dhe gjuhën e urrejtjes përmbledhen tek disa nene të Kodit të Transmetimit. Ky Kod orienton qartë mediat audiovizive në transmetimet e tyre për të respektuar të drejtat e njeriut:

- a) përmes raportimit jo-diskriminues të gazetarit mbi baza gjinore;
- b) përmes përdorimit të terminologjisë neutrale në aspektin gjinor;
- c) përmes respektimit të parimeve të privatësisë dhe ruajtja e konfidencialitetit (mbrojtja e të dhënave personale).

Në thelb të Kodit janë normat, kërkesat morale dhe etike, që duhet të respektojnë gjatë transmetimeve Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA), si medime të pavarura gjatë funksioneve të tyre informative, kulturore, argëtuese dhe edukative.

Por, a zbatohen de facto rregullat e parashikuara në Kod dhe me ç'shida përballen gazetarët në terren dhe në mjediset e televizioneve lokale?

Monitorimi i kronikave të edicioneve informative në disa televizione lokale, pyetësorët me gazetarët dhe intervistat personale në terren, si dhe analiza e përmbajtjes së ankesave që depozitohen nga publiku dhe institucionet pranë Këshillit të Ankesave testojnë tezën e këtij punimi se, mentaliteti i audiencave lokale, por dhe rrethana të tjera social-kulturore përcaktojnë konsiderueshëm terminologjinë e përmbajtjes së kronikave të televizioneve lokale.

Ajo çka konstatohet është se, në tërësi, mediat lokale kanë tendencën të jenë më të përpikta dhe më të përmbajtura në pasqyrimin e fakteve dhe në terminologjinë e përdorur në rastet e dhunës ndaj grave, fenomen që është vendosur në fokus të studimit, pasi këtu është momenti ku stereotipet mund të evidentohen më shumë se në rastet e tjera.

Në fokus të punimit janë televizionet lokale të qytetit të Shkodrës e të Vlorës, ku analizohen të dhënat e kronikave mbi dhunën ndaj grave të “Real Tv” dhe “Tv One” në Vlorë, dhe “Channel 1” e “Star Plus” në Shkodër. Janë zgjedhur këto dy qytete për arsye të një tradite të gjatë të zhvillimit të mediave televizive lokale, por dhe si zona me publik aktiv ndaj fenomeneve të ndryshme sociale, përfshirë dhe ato të dhunës me bazë gjinore.

Çfarë rezulton nga monitorimi i terminologjisë së kronikave të televizioneve lokale, që kanë pasqyruar çështje të dhunës ndaj grave? Gazetarët (burra dhe gra) kanë shfaqur rigorozitet në përdorimin e gjuhës së kronikave, duke evituar përdorimin e stereotipeve apo shprehjeve që cenojnë etikën. Të rralla janë konstatimet kur gazetari tejkalon etikën, duke e pyetur gruan e dhunuar - subjekt i kronikës (Vlorë, 7 qershor 2016) rasti i dhunimit të një nëne me dy fëmijë nga bashkëshorti i saj në mjedis publik - gjatë intervistës dhe tekstit të kronikës: “Pse keni qenë kaq e duruar gjithë kohës së dhunës dhe nuk jeni paraqitur për të kërkuar urdhër mbrojtje? A ndiheni e sikletosur pas kësaj dhune publike të bashkëshortit tuaj...etj”.

Në Shkodër, kronikat me fokus dhunën ndaj grave paraqiten edhe më korrekte në terminologji, sa u përket çështjeve të stereotipeve.

Gazetari i “Channel 1” Bepin Kolvataj thotë se, çështja e cenimit të etikës

dhe përdorimit të stereotipeve ka ardhur duke u evidentuar pas rritjes së denoncimeve të grave që dhunoheshin, pasi vite më parë denoncimet ishin të pakonsiderueshme: “Vitet e fundit, me shtimin e rasteve të denoncuar dhe punës së bërë nga shoqatat që merren me mbrojtjen e grave të dhunuara, apo fenomenin e dhunës në familje në tërësi, është punuar edhe për gjuhën që duhet përdorur kur raportohen këto fenomene. Ka ende problematika, por që gjatë rrugës, të paktën sa u përket gazetarëve lokalë në Shkodër, po rregullohen dhe tregohet një kujdes i veçantë në raportim”.

Kryeredaktorja Ebrieta Mecaj e “Real Tv” në Vlorë thotë se, gazetarët përpiqen t’u qëndrojnë korrekt fakteve të terrenit dhe të japin sa më pak subjektivizëm në interpretimin e tyre: “Në përgjithësi ka një lloj sensibilizimi, por fatkeqësisht e dëmtuara mbetet viktimja, e cila etiketohet si fajtoreshë ne opinionin publik dhe për këtë mjafton t’u hedhesh një sy komenteve të shikuesve në rrjetet sociale”.

Mos të harrojmë që Vlora si qytet ende nuk është çliruar plotësisht nga paragjykimet, se “ajo” është gjithmonë fajtoreshë dhe, në njëfarë mënyre edhe vetë mediat, në këtë rast mediat lokale duket se e mbartin frymën e qytetit.

Shpesh keqinformimi publik, fjalët e përdorura apo të papërdorura vijnë si rezultat i një mentaliteti të mbyllur dhe frika për të reaguara kundër paragjykit të një komuniteti, i cili në Vlorë vijon të mbetet prezent.

Efrosina Papa, kryeredaktore në “One Tv Vlorë”: “Jemi përpjekur në vijimësi në redaksinë tonë t’i shërbejmë një modeli sjelljeje me qëllim parandalimin e një gjuhe diskriminuese. Historitë e sjella nga raste trafikimi i kemi raportuar me ndjeshmëri ndaj viktimave, duke ruajtur konfidencialitetin, si dhe duke përjashtuar gjuhën diskriminuese. Kemi përjashtuar fjalën prostitutë dhe kemi përdorur fjalën viktimë. Kjo për të mos rënduar edhe me situatën e viktimës, por dhe për të mos cenuar efektivitetin e organeve ligj-zbatuese, si policia apo gjykata. Në rastet e sulmeve seksuale nuk kemi synuar identifikimin e viktimave. Po kështu, gjatë raportimit të krimeve nga të miturit mundohemi të tregojmë vetëpërbajtje në mbrojtje të së ardhmes së tyre”.

Po cilat janë sfidat e gazetarëve në raport mes përzgjedhjes së gjuhës korrekte dhe raportimit të një ngjarjeje të rëndë, sikurse është dhuna ndaj grave e vajzave?

Një vit më parë, një organizatë për të drejtat e grave dhe promovimin e tyre në vendimarrje -WDN -organizoi një Pyetësor, projekt bashkëpunimi me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) lidhur me trajtimin e dhunës me bazë gjinore dhe të drejtat e grave në televizionet lokale.

Nga Pyetësi me gazetarë dhe nga verifikimi i çështjeve në terren u mblodhën të dhëna të rëndësishme cilësore dhe sasiore: 13 gazetarë u shprehën se në mediat lokale nuk ka diskriminim, ndërsa 9 gazetarë pranuan se në kronika ka nota diskriminuese dhe stereotipe ndaj viktimës.

Gazetarët konstatuan se profilizimi i gazetarëve mbetet emergjencë në cilësinë e transmetimeve lokale;

-Në trajtimin e ngjarjes ndikojnë tiparet dhe kultura e mentalitetit patriarkal dhe të mbyllur të shoqërisë lokale;

-Gazetarët janë të ngurtë në trajtimin e ngjarjes, pasi në qytete të vogla “të gjithë njohin të gjithë”;

-Nevoja për më shumë seminare dhe forume mes mediave lokale, AMA-s dhe OJQ të të drejtave të grave dhe fëmijëve del si nevojë për të konfirmuar më shumë standarde në punën e mediave;

-Gazetarët mendojnë se, nga drejtuesit e redaksive lokale, por dhe nga qendra në Tiranë kërkohet që në rastet e dhunës në familje, të transmetohen sa më shumë element të skupit (scoop), të sensacionit në ngjarje, pse jo dhe qëndrime kritike të vetë gazetarit ndaj fenomenit. Ky lloj presioni ndaj korrespondentëve vjen dhe për shkak të interesave të ndryshme që ka “audienca heterogjene e kryeqytetit”, për lajme të kronikës së zezë, në krahasim nga ajo e një komuniteti më të vogël dhe më homogjen, siç është publiku i qyteteve të tjera.

Pyetjes ***nëse në median ku punoni a ekziston një Bord Etike dhe një Kod Etike***, të 25 gazetarët, target-grupi i Pyetësit në nivel kombëtar, u shprehën: Nuk ekziston.

Të gjithë gazetarët vlerësuan si të rëndësishëm ekzistencën e një Kodi Etike dhe, posaçërisht, një manuali për trajtimin e dhunës ndaj grave dhe fëmijëve;

-Nëse u është dhënë një udhëzues apo orientime në trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave apo çështje që lidhen me të drejtat e tyre, 13 gazetarë u shprehën se nuk kanë marrë udhëzime; 7 gazetarë thanë se kanë marrë udhëzime vetëm nga trajnimet e OJQ-ve apo Institutit të Medias;

-Çfarë mendojnë për rolin edukues dhe ndërgjegjësuës të medias në fenomenin e dhunës apo trafikimit ndaj gruas dhe fëmijëve? A ka diskriminim dhe qëndrim stereotipik ndaj tyre? Media, përmes gjuhës së përdorur për të trajtuar fenomenin e dhunës ndaj grave nxit fenomenin

apo ka rol frenues përmes informimit dhe ndërgjegjësimit?

14 gazetarë u shprehën se media, përmes trajtimit të dhunës në familje me një terminologji raportuese, përveçse informon, edhe ndërgjegjëson, edukon dhe publikun. Po këta gazetarë mendojnë se rastet e trajtuara në mënyrë jo-rigoroze kanë krijuar jo pak mosbesim dhe qasje kritike negativiste ndaj televizioneve;

10 gazetarë mendojnë se media vetëm informon, publiku gjykon vetë;

12 gazetarë mendojnë se media ka një rol kompleks, të ndërthurur mes frenimit dhe nxitjes;

10 mendojnë se media frenon publikun;

6 gazetarët sugjerojnë se duhen bërë sondazhe me target grupe të zgjeruara me publikun për perceptimin, përfshirë dhe besimin e tij mbi mediat për trajtimin që ajo u bën çështjeve të dhunës.

Pra, njohja e audiencës dhe opinionit i saj mbi rolin e medias është shumë e rëndësishme

-Çfarë duhet bërë, sipas jush, për të ulur efektet diskriminuese, përfshirë dhe qëndrimet me stereotipe që pasqyrohen jo rrallë herë në trajtimin në media të dhunës ndaj grave?

Shumica e gazetarëve u shprehën se, gazetarët e kronikës së zezë të profilizohen më tepër në çështjet e trajtimit të dhunës në familje, si dhe të ketë më shumë bashkëpunim me institucionet e profilizuara për të drejtat e njeriut.

6 gazetarë thanë se është përvoja që mëson gazetarët në misionin e tyre.

Ndërkohë nga monitorimet e ankesave që janë depozituar në AMA rezultojnë se vërejtjet e publikut ndaj mediave lokale janë shumë të pakta dhe nuk lidhen me gjuhën diskriminuese ose stereotipe të kronikave televizive. Ankesat lidhen vetëm me përmbajtje të imazheve me elementë dhune ose të karaktereve të tjera, sa më poshtë vijon:

Ankesa

1. Televizioni “Best Channel”, në edicionin e lajmeve të datës 05.02.2018, ka shfaqur një kronikë lajmesh të papërshtatshme me pamjet e një kamera sigurie për një aksident të rëndë, të ndodhur në qytetin e Elbasanit.
2. Ankesa e qytetarit A.H. lidhet me transmetimin e një filmi në televizionin “Star Plus” në Shkodër, në orën 21.00, që sipas tij kishte përmbajtje të lartë dhune dhe erotike. Qytetari pretendon se orari është i papërshtatshëm për familjen.
3. Ankesa e ardhur në adresën elektronike të Autoritetit të Mediave Audiovizive nga një shikues, i cili shprehej se “Tv Rozafa” ka transmetuar, në datën 24.06.2016, në orar të papërshtatshëm disa skena të rënda erotike në përmbajtjen e një filmi artistik.

Disa përcaktime që derivojnë nga analiza e të dhënave

1. Asnjë media lokale apo dhe ato publike kombëtare televizive nuk zotërojnë një Kod Etik apo manual në redaksitë e tyre - udhëzues që të përfshijë trajtimin e çështjeve të dhunës gjinore dhe ndaj fëmijëve në ekranin televiziv.
2. Gazetarët vlerësojnë si një standard të rëndësishëm për punën e tyre cilësore profesionale, ekzistencën e një manuali profesional të dedikuar me terminologji ligjore për trajtimin e dhunës ndaj grave dhe fëmijëve.
3. Gazetarët shprehen se media televizive në tërësi luan rol ndërgjegjësues dhe sensibilizues për çështjet e dhunës.
4. Ka dhe qëndrime të kombinuara ku media konsiderohet si një instrument kompleks informimi që luan një rol mes frenimit dhe nxitjes.
5. Gazetarët mendojnë se mediat publike kombëtare dhe lokale duhet të rrisin numrin e programeve mbi tema specifike gjinore, si dhe programe që trajtojnë rrezikun e përdorimit të stereotipeve dhe diskriminimit gjinor në mediat audiovizive dhe në internet.

Disa nga instrumentet më funksionale për minimizimin e stereotipeve tek mediat televizive lokale mund të jenë: Trajnimi i gazetarëve nga Instituti i

Medias, nga vetë ekspertët kombëtarë ose ndërkombëtare të atashuar pranë medimeve ku ata punojnë, qasje më të shpeshta në teoritë e komunikimit dhe mas-medias, shkëmbimi i përvojave dhe ekspertizave ndërkombëtare në fushën e etikës së informacionit televiziv. Nga ana tjetër, del rëndësia për të integruar në punën e medias, treguesit e ndjeshmërisë gjinore, një Udhëzues ndërkombëtar, i hartuar nga UNESCO.

Nevojitet gjithashtu një rritje cilësore e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave (veçanërisht të vendeve të BE-së) mes medias televizive lokale, AMA-s dhe posaçërisht Këshillit të Ankesave, institucioneve shtetërore për të drejtat e njeriut dhe organizatave joqeveritare për të drejtat e grave dhe fëmijëve, sikurse janë Avokati i Popullit, Komisionarët e të Drejtës së Informacionit, Mbrojtjes nga Diskriminimi etj.

GJUHA E URREJTJES NË BAZA KRAHINORE DHE ETNIKE NË MEDIAT AUDIOVIZIVE

DR. ALBAN TARTARI

Abstrakt

Mund të rastisen disa forma të gjuhës së urrejtjes në mediat audiovizive shqiptare dhe veçanërisht në televizion, si mediumi më i madh dhe më i përhapur në shoqërinë tonë. Një prej këtyre fenomeneve është edhe gjuha e urrejtjes me baza krahinore dhe etnike. Kjo gjuhë është sofistikuar veçanërisht nga zhargonet e përdorur nga gazetarët e lajmeve, që transmetohen në edicionet informative apo titrat që shfaqen në ekranet informative.

Etiketimet e personave të dyshuar për krime të ndryshme bëhen duke u përmendur origjinën e tyre krahinore, ashtu siç grupime të ndryshme kriminale gjithmonë mbajnë përsipër emrin e qytetit. Kemi ende raste në median audiovizive shqiptare që komunitete të ndryshme krahinore, si çamët, labët, kosovarët etj, etiketohen apo përgjithësohen, kur bëhet fjalë për fenomene negative që pjesëtarë të këtyre grupeve mund të ndërmarrin. Ka studiues të sociologjisë, që edhe parodizimet dhe skeçet komike në spektaklet televizive i konsiderojnë si një gjuhë e kamufluar e mos-tolerimit të tjetrit dhe, po ashtu, edhe si gjuhë e urrejtjes për një komunitet të caktuar. Nëse vihet re me kujdes në televizionet shqiptare, pavarësisht përpjekjes për disa standarde etike, mund të shquhen shumë raste të promovimit të stereotipeve që ekzistojnë tashmë për fqinjët në rajon.

Shprehjet e tifozërive sportive, që anatemojnë një qytet apo një komb tjetër, gjejnë vend shpesh në ekranet televizive, madje edhe amplifikohen nga media. Fakti që edhe tifozëritë e vendeve të tjerë e bëjnë të njëjtën gjë, nuk mund të jetë arsye që, ajo që ndodh në një grup të vogël tifozësh, të shpërndahet në mënyrë virale edhe te grupime të tjerë që ndodhen fizikisht larg kësaj ngjarjeje.

Gjithashtu, lajmet me tendencë negative lidhur me këto vende, gjejnë më shumë vend se lajmet pozitive, që nuk janë të pakta. Politika redaksionale që synon shikueshmëri të lartë dhe klikime në faqet e televizioneve në internet, shpesh anon nga lajmet negative dhe amplifikimi i tyre. Borde të certifikuara dhe konsoliduara etike, nevojiten në mënyrë që të parandalojnë këto fenomene, si dhe të marrin masa për shkeljet që mund të ndodhin në mediat audiovizive. Njëherazi, një ndërgjegjësim më i madh i gazetarëve, redaktorëve, regjisorëve dhe gjithë prodhuesve të përmbajtjeve radio-televizive duket po ashtu i nevojshëm.

Fjalë kyçe: gjuha e urrejtjes, mediat audiovizive, Shqipëri, rajon



Alban Tartari

Tashmë është pranuar roli i medias në tërësi dhe televizionit në veçanti, jo vetëm për të informuar dhe argëtuar publikun e gjerë, por edhe për t'i dhënë vend edukimit dhe ruajtjes së disa standardeve etike dhe sociale. Shumë autorë e konsiderojnë median edhe si një pasqyrë të shoqërisë, ku mjaft çështje që e karakterizojnë shoqërinë apo e shqetësojnë atë, shpesh gjejnë një vend në hapësirat mediatike.

Por nga ana tjetër, studimet e thelluara për median, dhe specifikisht televizionin si media me ndikimin më të madh në botë, theksojnë se kemi hyrë në një periudhë tjetër, ku televizioni ofron modele pozitive për shoqërinë në tërësi dhe qeverisjen në veçanti, ashtu siç e ka edhe fuqinë për të ndikuar në mënyrë negative në atë shoqëri.

Nisur që nga debati i parë i famshëm i drejtëpërdrejtë televiziv mes kandidatëve për President të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA), Kenedi dhe Nikson në vitin 1960, televizioni mori një rol të rëndësishëm në proceset demokratike, si promotori më i madh i demokracisë. Televizioni u bë simbiozë e fjalës transparencë. Përmes tij shoqëria pretendonte të arrinte të prekte tashmë pushtetin, artin, kulturën etj. Por duket se me “prekjen” që na ofrohet, shumë individë dhe grupe pretendojnë se idetë dhe mendimet e tyre duhet të përcillen përmes medias për të prekur shoqërinë në tërësi.

Televizioni vetvetiu tenton që t'i sjellë të gjithë në një mendje për kulturën, gjuhën, trendet, modën etj. Studiuesi Bruno Olivier thekson: “Televizioni masivizon përmasën kohore, duke bërë që miliona telespektatorë të jetojnë të njëjtën gjë, në të njëjtin çast, dhe duke i bërë të ndiejnë të njëjtat dëshira, të njëjtat pritje, të njëjtat pasione”.⁵ Ai shton se në prodhimin audiovizual, emisionet dhe mesazhet në përgjithësi mendohen tashmë në një logjikë fluksesh të pandërprera, që imponon një zhdukje të dallimeve.⁶ Pra, nga njëra anë kemi një diktat të ekranit, dhe nga ana tjetër dëshirë për të dalë jashtë këtij diktati nga elementë të shoqërisë.

Por si është përkufizimi i asaj që në anglisht ka marrë emërtesën “*hate speech*”, gjuhë e urrejtjes? Sipas fjalorit *Merriam-Webster*, gjuha e urrejtjes është një fjalim, deklaratë, shprehje që shfaq urrejtje për një grup të veçantë të njerëzve. Përkufizime bëhen edhe nga fjalorë të tjerë prestigjiozë, që e çojnë këtë çështje nga grupi deri te individi.

5 Olivier, Bruno. 2015. *Shkencat e komunikimit, teori dhe arritje*. Tiranë: Papyrus. F. 174

6 Po aty. F. 180

Studiuesja Anne Weber, në një botim të Këshillit të Evropës për gjuhën e urrejtjes, thekson se nuk ka një përkufizim të pranuar botërisht lidhur me këtë term, pavarësisht përdorimit shumë të shpeshtë. “Megjithatë shumë shtete kanë adoptuar ligje që ndalojnë rritjen e ‘gjuhës së urrejtjes’, përkufizimet e asaj që ndalohet ndryshojnë shumë nga njëri-tjetri. “Vetëm Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës 97(20) për “gjuhën e urrejtjes” e përkufizon si në vijim: termi gjuhë e urrejtjes duhet të kuptohet si përmbledhje e të gjitha formave të shprehjes që shpërndahen, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, anti-semitizmin ose format e tjera të urrejtjes, bazuar në mungesën e tolerancës, duke përfshirë: jotolerancën e shprehur nga nacionalizmi agresiv ose etnocentrizmi, diskriminim dhe armiqësi ndaj minoriteteve, emigrantëve dhe njerëzve me origjinë migratore”.⁷ Weber thekson se gjuha e urrejtjes dëshiron të godasë dinjitetin e atyre që shënjestron, në sytë e tyre si dhe në sy të anëtarëve të tjerë të shoqërisë.⁸ Kjo e dyta mund të ndodhë vetëm përmes mediave, veçanërisht përmes televizionit dhe internetit në kohën që jetojmë. Studiuesja Weber nënvizon, ndër të tjera, se ndoshta forca e ligjit përpiket të vendosë rregull dhe të parandalojë, vetëm duke kuptuar dhe aplikuar vlerat tona më të mira njerëzore, si dinjiteti, respekti i ndërsjellë, barazia, demokracia dhe paqja sociale, dhe kështu mund të bëjmë që ligji të kuptohet e të funksionojë.⁹ Dhe kjo, sigurisht, që është detyrë po e vetë medias.

Në fakt, kur flasim për gjuhën e urrejtjes sot, duhet të theksojmë se televizioni dhe radio nuk janë mediat më të prekura. Interneti është hapësira më e prekur nga gjuha e urrejtjes, pasi çdokush e ka mundësinë e komentit dhe të anonimatit. Por, kemi edhe studime të tjera që konfirmojnë se shumë nga stereotipet, mendimet dhe qëndrimet e gabuara në fakt kanë lindur si pasojë e ekspozimit ndaj përmbajtjeve televizive dhe radiofonike, si dhe të shtypit në tërësi. Pra, në internet, shpesh gjallojnë qëndrime që e kanë burimin në mediat tradicionale.

Një ndër elementët që ndikon në këtë përplasje është diversiteti kulturor brenda një shoqërie dhe mes shoqërive të ndryshme. Akademiku Artan Fuga e sheh diversitetin kulturor si një vlerë evropiane, ndërsa thekson se shqiptarët kanë interes të flasin “gjuhën” e diversitetit kulturor. Fuga sjell në shqip qëndrimet e studiuesve dhe filozofëve si Uill Kimlika, Jurgen Habermas, Zhak Derrida dhe Majkell Volcer. Këta emra të njohur theksojnë se “nuk ka kombe me identitet të

7 Weber, Anne. 2009. *Manual on hate speech*. Strasbourg: Council of Europe Publishing. F. 3

8 Waldron, Jeremy. 2012. *The harm in hate speech*. Londër: Harvard University Press. F. 5

9 Po aty. F. 14

“pastër”, domethënë pa minoritete dhe kultura të ardhura nga vendet fqinje”.¹⁰ Dhe më shumë se kaq, në kohën që jetojmë lëvizja ajrore e njerëzve bën që të miksohen edhe kultura që nuk ndajnë të njëjtin kufi dhe hapësirë territoriale.

“Stigmatë, dhe apriori negative, konotacione të ndryshme trashëgohen shpesh jo vetëm në raportet mes komuniteteve të ndryshme, por edhe qytet më qytet e zonë më zonë, si kudo, te të gjithë popujt.”¹¹ Problemi është kur këto stigmatë, në mënyrë të hapur apo të fshehur, gjejnë vend në transmetimet televizive dhe radiofonike. Walter Lipman thekson se “informacioni masiv është i drejtuar nga paragjykimet, interesa, dhe ka një natyrë shumë subjektive”.¹² Kjo do të thotë se nuk mund të presim një informacion tërësisht të pastër dhe pa ngjyrimet, qofshin këto edhe thjesht kombëtare. Çdo media në fakt flet për një shoqëri të caktuar dhe është e detyruar të respektojë kodet e saj.

Akademiku Fuga bazohet sërish te Lipman kur shkruan: “Iluzionet kolektive të opinionit publik i transmetohen medias dhe iluzionet kolektive të medias i transmetohen opinionit publik, duke krijuar një koherencë në një botë iluzore të ndërtuar nga bashkëveprimi media-opinion publik.”¹³

Fatkeqësisht ne rastisim disa forma të gjuhës së urrejtjes në mediat audiovizive shqiptare dhe veçanërisht në televizion, si mediumi më i madh dhe më i përhapur në shoqërinë tonë. Një prej këtyre fenomeneve është edhe gjuha e urrejtjes me baza krahinore dhe etnike. Kjo gjuhë është sofistikuar veçanërisht nga zhargonët e përdorura nga gazetarët e lajmeve, që transmetohen në edicionet informative apo titrat që shfaqen në ekranet informative. Etiketimet e personave të dyshuar për vepra penale të ndryshme bëhen duke u përmendur origjinën e tyre krahinore, ashtu siç grupime të ndryshme kriminale gjithmonë mbajnë përsipër emrin e qytetit. Kemi ende raste në median audiovizive shqiptare që komunitete të ndryshme krahinore, si çamët, labët, kosovarët etj. etiketohen apo përgjithësohen, kur bëhet fjalë për fenomene negative që pjesëtarë të këtyre grupeve mund të ndërmarrin. Shpesh vihen re titra në kanalet e lajmeve ku thuhet se “vlonjati qëllloi tre herë...”, “laçiani u largua në drejtim të paditur...” etj. Pra, përdorimi i emrit të qytetit përgjithëson në mënyrë të ndërgjegjshme apo të pandërgjegjshme banorët e asaj zone me një krim/vepër penale, të kryer në një moment të caktuar nga vetëm një individ ose grup.

10 Fuga, Artan. 2017. *Mediamorfozë dhe metakomunikim*. Tiranë: Papirus. F. 501

11 Po aty. F. 506

12 Po aty. F. 528

13 Po aty. F. 251

Studiues të sociologjisë theksojnë se edhe parodizimet dhe skeçet komike në spektaklet televizive janë një gjuhë e kamufluar e mos-tolerimit të tjetrit dhe, po ashtu, edhe si gjuhë e urrejtjes për një komunitet të caktuar. Fatkeqësisht në këto spektakle, vetë aktorë me origjinë nga këto zona, përpiqen të parodizojnë karaktere dhe zhargone, duke shënjestruar një zonë të tërë. Madje, në mënyrë të papranueshme kemi edhe parodizime të njerëzve që mund të kenë probleme mendore dhe çrregullime.

Nëse vihet re me kujdes në televizionet shqiptare, pavarësisht përpjekjes për disa standarde etike, mund të shquhen shumë raste të promovimit të stereotipeve që ekzistojnë tashmë për fqinjët në rajon. Një shembull konkret do ishte bezdia apo irritimi i shfaqur nga shqiptarët kur dëgjojnë se serbët përdorin termin negativ “*shiptari*”, ndërkohë që nuk ka asnjë vrasje ndërgjegjeje kur ne përdorim termin “*shkja*” për këtë etni. Mjafton të shohim me kujdes lajme që kanë të bëjnë me një incident të veçuar së fundmi në Bularat të Gjirokastrës, për të parë mënyrën si ne e shohim një person të një etnie tjetër. Në fakt, personi në fjalë ishte shtetas shqiptar me kombësi greke. Por fjala “greku” në shumë raste përdorej si diçka e keqe, duke ngatërruar origjinën e individit me veprimin e tij të gabuar personal, që është gjuajtja me armë dhe sulmi ndaj forcave të rendit.

E ndërsa dikur televizioni ishte “sundimtari” i vetëm mediatik në rang kombëtar dhe pati edhe tentativa globale (CNN, BBC, DW etj.), studiuesi i njohur Dominique Wolton, duke analizuar komunikimin në shoqërinë e sotme interaktive të internetit, e sheh në këtë mënyrë situatën: “...televizioni në plan kombëtar është një faktor i modernitetit, i kohezionit shoqëror dhe kulturor, i identitetit kombëtar, sepse ekziston një kulturë e përbashkët. Nga ana tjetër, në planin botëror, televizioni nuk ka të njëjtin rol, sepse nuk ka një kulturë të përbashkët; përkundrazi, ai ka një funksion informativ, zbavitës dhe kontribuon gjithashtu në ruajtjen e identiteteve kombëtare”.¹⁴ Problemi lind kur ky televizion mbart përballë miliona shikuesve gjuhën dhe qëndrimet e rrugës për një fenomen të caktuar në rang rajonal, kombëtar apo ndërkombëtar.

Shprehjet e tifozerive sportive, që anatemojnë një qytet apo një komb tjetër, gjejnë vend shpesh në ekranet televizive, madje edhe amplifikohen nga media. Fakti që edhe tifozëritë e vendeve të tjerë e bëjnë të njëjtën gjë, nuk mund të jetë arsye që ajo që ndodh në një grup të vogël tifozësh, të shpërndahet në mënyrë virale edhe të grupime të tjerë, që ndodhen fizikisht larg kësaj ngjarjeje. Gjithashtu, lajmet me tendencë negative lidhur me këto vende, gjejnë më shumë vend se lajmet pozitive që nuk janë të pakta. Politika redaksionale që

synon shikueshmëri të lartë dhe klikime në faqet e televizioneve në internet, shpesh anon nga lajmet negative dhe amplifikimi i tyre. Për shembull, rrahja e dy të rinjve shqiptarë në një rast periferik në një qytet të Serbisë, zuri për ditë të tëra një minutazh të gjerë në lajmet në Shqipëri. Ndërkohë, me dhjetëra organizime rajonale, ku qindra të rinj dhe profesionistë nga Shqipëria marrin pjesë dhe mirëprehen në Serbi, Bosnje, Maqedoni etj. nuk gjejnë asnjë lloj promovimi.¹⁵

Gjithashtu mund të vihen re lehtësisht shumë raste të diskriminimeve fetare dhe gjinore, sidomos për pjesëtarët e komunitetit LGBT. Shpesh, të ftuar të ndryshëm në studio televizive lejohen të thonë çfarë të duan; politika redaksionale e televizionit distancohet, por gjithsesi, ai ekran është përdorur për të përçuar gjuhën e urrejtjes ose më së paku gjuhën e mos-pranimi dhe mungesën e tolerancës. Pra, kur vjen puna te televizionet dhe radiot, nuk mjafton vetëm distancimi, por edhe mos-përfshirja dhe deri te bojkotimi i personave të tillë, që të drejtën e mendimit, fjalës dhe shprehjes e keqpërdorin për të sulmuar një komunitet të caktuar.

Nga ana tjetër, zotëruesit e mediave nga ana financiare dhe editoriale, duhet të kuptojnë se TV dhe radiot nuk janë pronë e tyre, por “pronë” e qindra-mijëra (ndoshta miliona) dëgjuesve dhe telespektatorëve. Pa këtë audiencë, këto media nuk kanë asnjë kuptim dhe asnjë vlerë. Një vetërregullim mediatik është i nevojshëm, për të garantuar një gjuhë të pranueshme demokratike në të gjitha produksionet mediatike. Borde të certifikuar dhe konsoliduara etike nevojiten, në mënyrë që të parandalojnë këto fenomene, si dhe të marrin masa për shkeljet që mund të ndodhin në mediat audiovizive. Kjo duhet të ndodhë nga brenda mediave, si një filtër që nuk do lejonte shfaqjen e një niveli të papranueshëm të diskursit publik. Ashtu siç u kërkojmë fabrikave dhe uzinave të mëdha të vendosin filtra për të mos lejuar gazrat e dëmshëm për mushkëritë tona, ashtu edhe mediat duhet të vendosin filtra për të mos helmuar mendjet tona.

Njëherazi, një ndërgjegjësim më i madh i gazetarëve, redaktorëve, regjisorëve dhe gjithë prodhuesve të përmbajtjeve radio-televizive duket i nevojshëm. Kjo mund të ndodhë vetëm përmes programeve të vazhdueshme të trajnimit dhe certifikimit, që mund të jenë prioritet i vetë mediave audiovizive, por edhe i Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA).

15 Ky është një vëzhgim i kryer përgjatë një viti, gjatë punës me Fondin e Ballkanit Perëndimor në rajonin e Ballkanit.

Në një botë që ndryshon përditë, mësimi në vijimësi¹⁶ është një domosdoshmëri për të përmbushur gjithashtu standardet në ndryshim. Vihet re që kanalet më në zë në arenën ndërkombëtare kanë programe të vazhdueshme të trajnimit, jo vetëm në aspektin e ngritjes profesionale të punonjësve, por edhe në kuptimin e realiteteve të reja dhe situatave të ndryshueshme në rang lokal, rajonal, kombëtar e ndërkombëtar. Është e pamundur të ecet përpara drejt një mentaliteti të ri, ndërkohë që jetohet brenda një mendësie të vjetër. Lëndët e etikës duhet të marrin rëndësi parësore edhe në shkollat e komunikimit dhe të gazetarisë.

Nga ana tjetër, masa më të ashpra financiare (gjoba) dhe administrative mund të shihen si një zgjidhje përfundimtare, në përpjekjet për të luftuar kundër gjuhës së urrejtjes. Kemi modele nga vendet demokratike perëndimore, se si autoritetet e mediave mund të shkojnë deri në masa drastike, si ndërprerja e transmetimeve për një kohë të caktuar, në rast se nuk merret seriozisht gjuha e urrejtjes e përçarur nga këto media.

Gjithashtu, një bashkëpunim më i ngushtë mes medias, AMA-s dhe institucioneve publike (drejtuesve më të lartë dhe zyra të shtypit/komunikimit/marrëdhënieve publike) duket mëse i nevojshëm. Shpesh, drejtues të institucioneve shkelin rregullat bazë të etikës në fjalimet, deklaratat, dhe shprehjet që përdorin në publik, dhe ç'është më e keqja, nga foltoret me emblemën zyrtare të informacionit. Vetë mediat, në kushtet normale të një shoqërie të përgjegjshme demokratike, do të duhej t'i bojkotonin këta zyrtarë, të çfarëdo pjese të spektrit politik për të vijuar me dalje publike. Zyrtat e shtypit dhe drejtuesit e marrëdhënieve publike nuk mund të jenë zyrtarë pasivë, por gardianë të etikës dhe komunikimit demokratik në shërbim të shoqërisë.

Burime

- Fuga, Artan. 2013. *Komunikimi në shoqërinë masive*. Tiranë: Papyrus.
 —. 2017. *Mediamorfozë dhe metakomunikim*. Tiranë: Papyrus.
 Olivier, Bruno. 2015. *Shkencat e komunikimit, teori dhe arritje*. Tiranë: Papyrus.
 Tartari, Alban. 2017. *Marrëdhëniet me publikun*. Tiranë: Toena.
 Waldron, Jeremy. 2012. *The harm in hate speech*. Londër: Harvard University Press.
 Weber, Anne. 2009. *Manual on hate speech*. Strasbourg: Council of Europe Publishing.
 Wolton, Dominique. 2009. *Të shpëtojme komunikimin*. Tiranë: Papyrus.

16 Term që përmbledhet në anglisht me *LLL – life long learning*, pra mësimi përgjatë gjithë jetës

GJUHA E URREJTJES: FORMA DHE HAPËSIRA QË GJEN NË EKTRANET TELEVIZIVE SHQIPTARE

Doc. Dr. RAMADAN ÇIPURI

Abstrakt

Nisur nga realiteti gjithëpërfshirës për të gjithë llojet e mediave në ditët e sotme, përmbysja e hierarkisë së dikurshme redaksionale, apo edhe format e reja të komunikimit të brendshëm në institucionet mediatike, gjuha e urrejtjes, format dhe përdorimi i saj janë bërë pjesë e pandarë edhe ofertës televizive, e cila mendohet se ka një kontroll të rreptë para se t'i ofrohet audiencave. Ky studim do të analizojë gjuhën e urrejtjes në ekranet e televizioneve shqiptare, format dhe impaktin që ajo përcjell në shoqëri. Studimi do të mbështetet kryesisht në një analizë cilësore, ku do të vlerësohet si kuadri ligjor rregullues dhe vetërregullues i mediave, po aq edhe hapësira, format dhe aktorët e përfshirë brenda medias në këtë fenomen. Studimi pritet të mbërrijë në përfundime se, televizionet shqiptare përgjithësisht shfaqen të kujdesshëm në hapësirën që i kushtojnë gjuhës së urrejtjes, por ajo bëhet pjesë kryesisht e debateve politike dhe përcillet përmes citimeve të personazheve të përfshirë në ngjarje.

Fjalët kyçe: gjuha e urrejtjes, televizionet, lajme, etika në media

“LIRIA E SHPREHJES” PËRBALLË “GJUHE SË URREJTJES”

Mënyra se si është trajtuar “Liria e shprehjes” dhe “Gjuha e urrejtjes” nga ligjvënësit dhe studiuesit në vende të ndryshme të botës ka nxitur paqartësi të shumta në kufijtë e asaj se ku nis e mbaron e para dhe ku fillon e dyta. Kjo situatë, në vetvete, krijon paqartësi në trajtimin e fenomeneve dhe në masat që duhen ndërmarrë ndaj tyre. Raporti midis tyre ka pësuar një paqartësi akoma më të madhe, sidomos varësisht zhvillimeve teknologjike në të cilat është përfshirë teknologjia e informacionit.



Liria e shprehjes është ndër të drejtat e para të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ku në nenin 22 pika 1 të tij thuhet shprehimisht se “Liria e shprehjes është e garantuar”. Nga ana tjetër, Neni 265 i Kodit Penal, i dedikohet “Nxitjes së urrejtjes ose grindjeve” dhe përcakton se “Nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve, për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja, me qëllim përhapjen e shkrimeve me përmbajtje të tilla, e kryer me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet”.¹⁷

Analizuar në një rrafsh ndërkombëtar, liria e shprehjes buron nga aktet juridike ndërkombëtare. Rregullimi i parë ndërkombëtar në lidhje me këtë çështje u bë në vitin 1948, me nënshkrimin e “Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut”, e nënshkruar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, e cila në nenin 19 të saj vlerëson se “Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit

17 *Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. 2016. (Kuvendi i Republikës së Shqipërisë). Neni 256*

dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe njoftimit të informacionit dhe ideve me çfarëdo mjeti qoftë, pa marrë parasysh kufijtë”.¹⁸ Kjo deklaratë u pasua nga shumë konventa të tjera ndërkombëtare, të cilat përforcojnë gjithnjë e më shumë lirinë e shprehjes së individëve.

Nga ana tjetër, masat kundër gjuhës së urrejtjes kanë nxitur shumë vende që të miratojnë ligje shumë të rrepta. Sipas një ligji të miratuar në qershorin e vitit 2017, në Gjermani u kërkohet kompanive të mediave sociale të largojnë postimet e paligjshme ose të paguajnë gjoba që arrijnë deri në 50 milionë euro. Përballë këtyre masave dhe ligjeve, në shumë vende ka pasur edhe një valë skepticizmi të ekspertëve, se situata mund të derivojë në censurë dhe të kufizojë lirinë e shprehjes.

“Nga debatet e ekspertëve dhe nga propozimet e shumta për këtë, mund të nxjerrim një përkufizim sintetik i cili, para së gjithash, do të jetë doktrinar: Gjuha e urrejtjes është një lloj i të shprehurit i dizenuar që të promovojë urrejtje në bazë të racës, religjionit, përkatësisë etnike, origjinës kombëtare, gjinisë, orientimit seksual, prejardhjes klasore/sociale, pengesave trupore ose mendore”.¹⁹

Nisur nga kjo situatë dhe nga përcaktimet që Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë bën në lidhje me gjuhën e urrejtjes, ngremë pyetjen se ku pozicionohen televizionet shqiptare në raport me mundësitë dhe hapësirën që i ofrojnë përmbajtjeve të tilla?

Gjuha e urrejtjes në diskursin mediatik dhe ndikimi që ka në shoqëri

Që në fillim të kësaj analize, duhet theksuar se “të vlerësosh një sjellje të përgjegjshme etike si kufi të censurës është një absurditet. Etika nuk është censurë. Etika mbron dhe pasqyron botën e vlerave, dhe kryesisht vlerat dhe dinjitetin njerëzor.”²⁰ Janë të rrallë ata studiues që do ta kundërshtonin lirinë e medias, por, nga ana tjetër kjo liri nuk do të thotë se vetë media mund dhe duhet të përjashtohet nga përgjegjësia që ka. Nuk ekziston asnjë lloj lirie, përfshi këtu edhe lirinë e shprehjes që të jetë absolute. “Ajo kufizohet nga detyra

18 *Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut*. 1948. (Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 10 Dhjetor). Neni 19

19 Mihajlova, Elena, Jasna Bačovska, dhe Tome Shekerxhiev. 2013. *Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes*. Shkup: Polyesterday. F.24

20 Drożdż, Michał. T. 35 (2016) nr 5. «Hate Speech in Media Discourse.» *Acta Universitatis Lodziensis. Folia Litteraria Polonica*. F.20.

për të respektuar dinjitetin e të tjerëve dhe lirinë e tyre legjitime. Nuk duhet të shkruhen, të krijohen dhe të transmetohen programe nëse ato dëmtojnë të vërtetën: jo vetëm të vërtetën faktike që përcillet, por edhe 'të vërtetat rreth një genieje njerëzore', dinjitetit të një personi në të gjitha dimensionet"²¹.

Realiteti artificial i urrejtjes që buron nga media

Studiues të ndryshëm kanë venë theksin mbi konfrontimin që ndodh midis realitetit që përcillet nga media dhe atij që ndodh në të vërtetë. Mesazhet që përcillen përmes medias, në rastin konkret përmes ekranit të televizionit, shpesh herë nxisin realitete artificiale për njerëz që vijnë dhe që u përkasin formimeve të ndryshme social-kulturore. Këto realitete artificiale varen nga aktorë të ndryshëm, duke nisur nga politikat redaksionale të medias, e deri tek profesionalizmi apo qëllimi që mund të ketë edhe vetë gazetari që raporton, por pse jo edhe nga botëkuptimi (interpretimi, keqkuptimi, aftësitë) që grupe të caktuara shoqërore mund të shfaqin në lidhje me historitë e trajtuara përmes medias. Të ekspozuar përballë këtyre imazheve, audiencat arrijnë deri në atë pikë sa të mos bëjnë dallime midis realitetit që paraqitet në ekran dhe atij që është në të vërtetë. Përgjithësisht triumfon realiteti artificial i ndërtuar përmes përmbajtjeve që burojnë nga media. Nëse do ta analizonim këtë ndikim duke iu referuar efekteve që mund të ketë gjuha e urrejtjes që buron nga media, mund të themi se kjo qasje mund të krijojë realitete artificiale të urrejtjes, të cilët me kalimin e kohës dhe përmes proceseve të ndryshme mediatike mund të sjellin pasoja të mëdha sociale dhe të përshkallëzuara.

Studiuesi polak Michał Drożdż në "Institutin e gazetarisë dhe komunikimit social", pranë "*Pontifical University of John Paul II*", ka analizuar këtë çështje, duke e paraqitur realitetin që përcillet përmes medias si përcaktues për realitetin e perceptuar nga audiencat, edhe pse në të vërtetë ai mund të jetë ndryshe.²² Sipas Drożdż, realiteti po formësohet gjithnjë e më shumë sipas rregullave të mediave. Gjuha e urrejtjes së medias adopton disa karakteristika performuese, të cilat krijojnë një botë artificiale të urrejtjes. Kjo botë depërton në botën reale të marrëdhënieve ndërpersonale.

Së dyti, bota mediale dhe realiteti përplasen në një pikë, duke relativizuar dhe mjegulluar gjithnjë e më shumë kufijtë e realitetit që po ndërtohet përmes medias. Në këtë mënyrë, audiencat po humbasin aftësitë për të bërë dallimin midis urrejtjes në realitet dhe përshkrimit që i bëhet asaj në media.

21 Po aty. F.23

22 Drożdż, Michał. T. 35 (2016) nr 5. «Hate Speech in Media Discourse.» *Acta Universitatis Lodzensis. Folia Litteraria Polonica*. F.24.

Më tej, Drozdz thotë se sot ka shumë politika që ndërmerren dhe organizohen vetëm falë mundësisë që ekziston për tu paraqitur dhe promovuar përmes medias. Media zotëron aftësi për të krijuar emocione të forta urrejtjeje në realitetin që ekziston përtej saj.

Media arrin të ndikojë në paqartësinë e vijës dalluese midis realitetit në terren dhe mënyrës se si ai paraqitet në ekran. Forma dhe mënyra se si raportohet një ngjarje perceptohet nga audiencat si një model real i historisë, dhe bën që kuptimi mbi realitetin, gjithnjë e më shumë të formohet nga imazhet e fiksuara përmes raportimeve mediatike.

Problemi në këto raste qëndron në atë se përmes raportimeve të kësaj natyre, duke i dhënë hapësirë gjuhës së urrejtjes dhe ngritjes e zhvillimit të disa realiteteve artificiale, media mund të nxisë armiqësi e konflikte të ndryshme; mund të prodhojë një lloj mendësie dhe psikologjie turmash “Ne kundër tyre”; mund të injorojë njërën palë dhe të lartësojë palën tjetër, duke i hapur kështu rrugë stereotipeve të shumta që mund të rezultojnë në konflikte me pasoja fatale për shoqërinë.

Televizionet shqiptare dhe gjuha e urrejtjes

Siç e përmendëm edhe më sipër, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë e lidh këtë fenomen me urrejtjen dhe grindjen që mund të shkaktohet për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual.

Që në fillim vlen të theksohet se televizionet shqiptare, në vija të përgjithshme janë treguar të kujdesshëm përsa i përket nxitjes së urrejtjes dhe grindjes që mund të burojnë nga përmbajtjet raciste, anti-fetare apo homofobe. Ky kujdes, siç mund të burojë nga kuadri legjislativ që rregullon këtë çështje, po aq mund të jetë edhe si rezultat i normave sociale që karakterizojnë shoqërinë shqiptare në përgjithësi. Janë shumë të rrallë ato raste, për të mos thënë se nuk ekzistojnë, ku nga punonjësit e medias, përfshi këtu gazetarë, moderatorë, drejtues të tyre, etj., të dëgjohen vlerësime që cenojnë dinjitetin e njeriut për arsye të racës, besimit fetar, apo qasjes seksuale. Por, pavarësisht kësaj, gjuha e urrejtjes dhe dhuna verbale në ekranet e televizioneve tona na shfaqet në sasi të konsiderueshme përmes citimeve të personazheve që përfshihen në përmbajtjet informative, po aq edhe në formatet *Talk Show* të kudogjendura në pothuajse çdo operator audio-viziv, apo pse jo edhe në kategori të tjera ku përfshihet programacioni televiziv.

Pas ndryshimeve të regjimit në fund të shekullit të kaluar, shoqëria shqiptare është përfshirë nga një shkallë e lartë politizimi. Rol në këtë gjë ka luajtur padyshim edhe forma e raportimeve mediale, e cila i krijon hapësira të gjera komunikimit politik, e që fatkeqësisht shoqërohet me akuza të ndërsjella dhe

një dhunë të vazhdueshme. E ekspozuar përballë një komunikimi të tillë, shoqëria shqiptare ka shfaqur nivele të larta politizimi.

Nga një analizë që mund t'i bëhet përmbajtjes mediatike që përfshin edhe gjuhë urrejtjeje, ndër shumë të tjera që mund të ekzistojnë, vëmë re dimensionet e mëposhtme të përdorimit të saj.

E para, gjuha e urrejtjes e përcjellë përmes personazheve të përfshirë në historitë e raportuara targeton grupe/individë të veçantë. “Në të gjitha përkufizimet që i bëhen gjuhës së urrejtjes, ato vënë theksin se ajo bazohet në karakteristika të veçanta të grupeve të ndryshme, si origjina etnike, fetare etj.”²³

Së dyti, kjo lloj gjuhe synon nxitjen e urrejtjes dhe të dhunës. Njësoj si më sipër, të gjithë përkufizimit e këtij fenomeni fokusohen në dhunën që një gjuhë e tillë mund të pasojë.

Së treti, gjuha e urrejtjes synon organizimin e sulmeve apo aksionit që mund të burojë nga emocioni që ajo shkakton tek audiencat e ndryshme.

Varësisht këtyre dimensioneve, vlen të analizojmë edhe disa raste që janë shfaqur dhe vijnë të shfaqen në ekranet e televizioneve shqiptare.

Gjuha e urrejtjes përmes edicioneve informative

Edhe pse lajmet e kronikës janë ato që zënë hapësirën më të madhe të kohës televizive në edicionet informative të televizioneve shqiptare, në fakt gjuhën e urrejtjes e ndeshim më shumë në lajmet rreth aktualitetit politik, në diskursin publik të politikanëve, i cili përcillet përmes kanaleve mediatike. Përfaqësues të kaheve të ndryshme politike shkëmbejnë akuza e fyerje mes tyre, ndërkohë që televizionet i përcjellin ato herë të filtruara, e më shpesh ashtu siç burojnë. Kjo është një situatë që ushqen një sërë dilemash etike, në kushtet kur mënyrat e raportimit televiziv janë të formave të ndryshme dhe mundësitë për nivel profesional raportimi variojnë sipas tyre. Forma kryesore e përmbajtjes së edicioneve informative është ajo e regjistruar më parë dhe e përgatitur për publikim duke kaluar përmes filtrave redaksionalë. Mënyra tjetër është raportimi *live* nga vendi i ngjarjes, si salla e Kuvendit, seli të subjekteve politike, sheshe etj..

Të dyja rastet kanë specifikat e veta të raportimit, por dilemat etike dhe përgjigjet ndaj tyre vlejnë për t'u diskutuar më shumë në rastin e parë. Kjo, pasi aty ekziston koha dhe mundësia për të diskutuar dhe për të vendosur disa standarde para se lajmi t'i shërbehet publikut. Kjo gjë duket më e vështirë për t'u administruar në transmetimet direkte, ku pse jo, në shumë raste mund të

23 Fortuna, Paula, dhe Sérgio Nunes. 2018. «A Survey on Automatic Detection of Hate Speech in Text.» *ACM Computing Surveys*. doi:<https://doi.org/10.1145/3232676>. F.5

gjenden edhe justifikime të pranueshme për standardet e etikës profesionale. Shqetësimi ynë qëndron pikërisht aty ku redaksitë e kanë mundësinë për ta bërë, por nuk e kalojnë informacionin siç duhet përmes filtrave redaksional, duke e përcjellë atë me nota të larta urrejtjeje e fyerjeje, pasojat e së cilave mund të jenë të paparashikueshme. Këto raste janë nga më të ndryshmet, duke nisur nga postimet në profilet publike në rrjete sociale të drejtuesve të lartë politikë, e deri tek deklaratat që mund të bëhen nëpër debate të ndryshme televizive.

Një rast, i cili mund të konsiderohet banal për diskutime të kësaj natyre, por që u transmetua gjerësisht nga pothuajse të gjithë kanalet televizive, ishte mesazhi i unifikuar i tre funksionarëve socialistë, Kryeministri Edi Rama, ish ministri i Brendshëm Saimir Tahiri dhe Kryetari i Bashkisë Durrës, Vangjush Dako, kur në situata të ndryshme përsëritën të njëjtën shprehje, “Nuk ka bir k*rvë që...”. I pari ishte z.Rama, i cili në vitin 2002, asokohe kryetar i Bashkisë së Tiranës, u përball me një komision parlamentar për të hetuar abuzimet e Bashkisë, në lidhje me ndriçimin e rrugëve dhe koncertin e “Scorpions”. Shprehja e mësipërme u përdor gjerësisht nëpër media, por pse jo edhe në spotet e kampit opozitar. Më tej, ishte Saimir Tahiri, i cili në momentin që u përball me akuzat për përfshirje në trafikim lëndësh narkotike, më 19 prill 2018, përdori gjuhën e shefit të tij, duke thënë se “s’e besoj se do ketë bir nëne dhe bir k*rvë që të më ndalojë për të bërë drejtësi”. I treti ishte Vangjush Dako, i cili më 25 tetor 2018, në studion e emisionit “Opinion” në TV Klan citoi të njëjtat fjalë, për një situatë të ngjashme. Të tri këto raste gjetën hapësirë në edicionet informative të pothuaj të gjithë televizioneve. Për shumë analistë, kjo shprehje u vlerësua si një kod i veçantë komunikimi, përmes të cilit dy të fundit i dërgonin mesazhe shantazhuese shefit të tyre.

Është e vështirë të përcaktosh se sa redaksitë e informacionit kanë diskutuar për një dileme etike rreth mënyrës së publikimit të këtij rasti. Por, aty duheshin diskutuar së paku dy alternativa.

E para, fjalët e tre personazheve duhej të përcillehin siç ishin, pasi përmes tyre qytetarët shqiptarë mund t’i vlerësonin ato si kode të fshehta komunikimi dhe shantazhi që personazhet në fjalë i bënin njëri-tjetrit dhe do të kuptonin më mirë aferat dhe shkeljet ligjore në të cilat ata mund të ishin përfshirë.

E dyta, a duhet që një gjuhë e tillë, e përdorur përgjithësisht në mjedise krejt informale dhe të pazakonta, t’u përcillet audiencave të gjera, gjë kjo që mund të nxisë shqetësim, nervozizëm dhe reagim.

Edhe në edicionet informative kryesore të televizioneve kombëtare gjen tituj

të tillë që nxisin debate të gjera etike në lidhje me këtë çështje, si “Rama për Bashën: Konferencë shtypi me diarre intensive. 23 shkaqe për padi” në TV “Top Channel” më 30 tetor, 2018, e ngjashme kjo edhe në TV “Klan” dhe shumë kanale të tjera.

Një ndër shumë raste që vlen të diskutohet përsa i përket gjuhës së urrejtjes së përcjellë përmes edicioneve informative, por jo vetëm, është raportimi që iu bë nga televizionet shqiptare ceremonisë së varrimit të Kostandinos Kacifas, i cili u qëllua për vdekje nga forcat RENE, pasi qëllloi me armë zjarri për disa minuta ndaj efektivëve të policisë. Shumë prej ekraneve televizive shqiptare transmetuan *live* ceremoninë në fjalë, ku ndër të tjera u dëgjuan edhe thirrjet e qytetarëve grekë të pranishëm aty, si “Vorio Epiri është Greqi”, “Maqedonia është Greqi”, “Gjaku na thërret të djegim shqiptarin”, “Shqiptarë të poshtër”, “Zjarr kundër qenve shqiptarë”, “Gazetarët shqiptarë janë të poshtër”, etj.

Dilema e parë për një redaksi informacioni në lidhje me këtë rast është se a duhej transmetuar *live*, apo jo. Kjo njëkohësisht përbën edhe një dileme deontologjike për grupin e gazetarëve të përfshirë në raportim. Nga aspekti deontologjik, dilema që kërkon përgjigje në këtë rast është nëse transmetimi direkt ka ndikim në kuptimin dhe qartësimin më të mirë të situatës, apo ka efektin e kundërt që mund të nxisë një reagim agresiv të qytetarëve shqiptarë, gjë që mund të përshkallëzonte akoma më tej konfliktin mes palëve. Ky konflikt me baza etnike, mund të kishte pasoja sa diplomatike, po aq edhe sociale dhe ekonomike për popujt e të dy vendeve. Në mungesë të mundësisë për të transmetuar çdo detaj rreth zhvillimeve në vendin e ngjarjeve, apo edhe të preferencës së operatorëve dhe gazetarëve për t’u pozicionuar atje, ekrani televiziv ndikon pikërisht në ndërtimin e realitetit artificial që u citua më sipër, duke e formësuar atë në mendjen e njerëzve si diçka të vërtetë dhe të panegociueshme.

Dilema e dyta në këtë rast është nëse gazetari duhej të transmetojë dhe të përcjellë çdo detaj që ndodh në vendin e ngjarjes, apo t’i përmbledhë ato në një fjali. Nëse do t’i raportojë të gjitha fyerjet dhe sharjet me nota të larta raciste dhe urrejtje etnike, atëherë aty duhet të përmenden të gjitha sloganet e përmendura më sipër. Nga ana tjetër, një fjali përmbledhëse, si “Gjatë ceremonisë së varrimit pjesëmarrësit hodhën edhe slogane raciste...” mund të ishte një tjetër alternativë. Gazetarëve dhe drejtuesve të redaksive të informacionit u duhej që në këtë rast të përllogarisnin mirë pasojat e mundshme.

Një tjetër dilemë që duhej analizuar është edhe komunikimi midis gazetarit në studio dhe atij në terren. Përgjithësisht, gazetari në studio nuk arrin dot të përcaktojë situatën në terren, duke iu drejtuar gazetarit në vendin e ngjarjes me pyetje të ndryshme, apo duke i kërkuar atij që të intervistojë personazhe që janë të pranishëm. Për rastin në fjalë, moderatorët nga studiot televizive u kërkonin gazetarëve në terren pikërisht këtë gjë, që të sillnin para kameras

pjesëmarrësit në ceremoninë e varrimit të Kacifasit. Duke mos i njohur të pranishmit, gazetari në terren mund t'ia drejtonte mikrofonin gjithkujt që ishte i pranishëm aty, gjë kjo që varësisht qëndrimit dhe bindjes së tyre, ose mund ta mitizonte më shumë viktimën, ose mund dënonte akoma më shumë në opinionin publik ndaj tij. Pra, këto situata kërkojnë një vlerësim shumë të kujdesshëm, pasi edhe raportet e aktorëve të ndryshëm në gjithë zinxhirin e transmetimit të informacionit janë shumë delikate.

Gjuha e urrejtjes përmes programeve *Talk Show*

Njësoj si në rastin edicioneve informative, gazetarët shqiptarë përgjithësisht tregohen të matur përsa i përket gjuhës që ata vetë përdorin në lidhje me këtë fenomen. Por, nga ana tjetër, fenomeni i gjuhës së urrejtjes duket se gjen terren përmes temave që trajtohen dhe të ftuarve në studio. Është tipike e këtyre lloj emisionesh që debatet t'i zhvillojnë përmes të ftuarve që ndajnë pikëpamje të kundërta, mundësisht që nuk ndajnë asgjë të përbashkët. Kjo qasje duket se nxit ritmin e bisedës dhe debatit në studio, duke e bërë atë më tërheqës për audiencat. Në jo pak raste vihen re gazetarë që drejtojnë emisione me ndjekshmëri shumë të lartë, që u drejtohen të ftuarve me kërkesa si “Mos ma ul ritmin!”, “Më shumë tempo!” etj. Dëshira për të pasur diskutime me nota të larta debati, duket se stimulon dhe përcakton edhe atmosferën në të cilën përfshihen të pranishmit në studiot televizive.

Ndër shumë raste të tjera, një temë që mund të shtrohet për diskutim dhe që ka përcjellë gjuhë të rëndë urrejtjeje është ajo e titulluar “Parada pro gay dhe kundërshtarët”, e cila u transmetua përmes emisionit “Opinion” në TV “Klan”, më 2 prill 2012. Të pranishëm në studio ishin Delina Fico, aktiviste e të drejtave të njeriut, Kristi Pinderi, aktivist kundër homofobisë, Arian Çani, i prezantuar si gazetar liberal që shfaqet në mbrojtje të të gjithë minoriteteve. Përballë tyre ishin renditur Anjeza Xhaferaj, pedagoge dhe që shfaqet me veshje sipas përcaktimeve të besimit islam, Pastor Akil Pano, Murat Basha, nënkryetar i Partisë Lëvizja e Legalitetit. Mjafton të citosh vetëm disa nga fjalitë e shprehura nga pjesëmarrësit në këtë emision për të shpjeguar urrejtjen që mund të ushqehet përmes tij tek masat e gjera. Pas një shkëmbimi fyerjesh midis të pranishmëve dhe vlerësimit të z.Pinderi se, fëmijët nuk duhet të ushqeheshin nga mendimet e baballarëve që kanë qasje homofobike, reagimi i z.Basha ishte: “Nëse djali im do të të dëgjonte ty, atëherë do ta hidhja nga dritarja”. Pyetjes së Kristi Pinderit se “nëse fëmija juaj do të ishte homoseksual, çfarë do t'i thonit?”, Murat Basha i përgjigjet: “Me shpresën tek Zoti, e them publikisht! Do t'i gjuaja plumbin ballit! Pastaj do të pranoja të shkoja në burg”.

Edhe pse në transmetimet direkte këto janë situata që mund të dalin nga kontrolli, për t'u diskutuar mbetet fakti i mosndërhyrjes së moderatorit në studio, i cili mund të mendonte për mundësinë e ndërhyrjes në debat dhe mos lejitimit të arritjes deri në atë pikë. Në këtë rast mund të ngremë një çështje

të rëndësishme diskutimi etik, varësisht edhe pasojave që mund të kishte një emision i tillë. Dihet që shoqëria shqiptare vijon të jetë e mbyllur ndaj çështjeve që kanë të bëjnë me pranimin e të drejtave të komuniteteve Gay. Mund të ketë shumë prindër, të cilët nuk i pranojnë fëmijët që të jenë pjesë e këtyre komuniteteve. Varësisht mesazhit që po përcillej në studio dhe ndikimit që kanë emisione të tilla tek shoqëri të paedukuara mjaftueshëm mediatikisht, a do të ishte e pamundur që ndonjë prind me qasje të theksuara konservatore të nxirrte pistoletën dhe të qëllonte mbi fëmijën e tij homoseksual? Kjo dhe shumë të tjera mund të jenë dilema ndaj të cilave mediat dhe gazetarët duhet të tregojnë kujdes, sidomos kur bëhet fjalë për pasoja me kosto të larta.

Përfundime dhe rekomandime

Së pari, duhet vlerësuar fakti se literatura në lidhje me gjuhën e urrejtjes në përmbajtjet televizive është e kufizuar dhe kjo fushë kërkon studime të thelluara në lidhje me impaktin që ky fenomen ka mbi audiencat.

Pavarësisht kujdesit individual dhe përpjekjes për t'u zhveshur nga përgjegjësia e transmetimit të mesazheve që përmbajnë gjuhë urrejtjeje, mediat shqiptare e lejojnë atë të gjejë hapësirë dhe kohë televizive të gjerë. Problemi më i madh në lidhje me këtë rastiset në transmetimet direkte që mund të jenë si në edicionet informative, po aq edhe në emisionet e transmetuara në kohë reale.

Nga një analizë cilësore e përmbajtjes televizive në përgjithësi, vihet re se redaksitë e informacionit, por edhe në ekipet që angazhohen për emisione të veçanta, kërkojnë përpjekje më të mëdha vetërregulluese me fokus trajtimin e ngjarjeve që përcjellin gjuhë urrejtjeje.

Autoritetet rregullatore duhet të përcaktojnë një strategji më të qartë në lidhje me trajtimin e rasteve të tilla, duke forcuar masat e nevojshme, të ngjashme ato me praktika në vende të zhvilluara. Për të gjithë skeptikët e këtij sugjerimi për censurim të lirisë së medias, na duhet të risjellim në vëmendje se të raportosh bazuar në parime etike, kurrsesi nuk është censurë për mediat.

Së fundi, por që është edhe më e rëndësishme, televizionet shqiptare duhet të ngrënë bordet e etikës, të cilët janë shumë të rëndësishëm në epokën përmes së cilës media po kalon.

LAJMET E KRONIKËS: DETAJET QË NXISIN STEREOTIPE DHE URREJTJE TEK AUDIENCAT

Dr. ERLIS ÇELA

Abstrakt

Media shqiptare e pas periudhës komuniste ka adaptuar një model të mbulimit të aktualitetit, i cili fokusohet së tepërmi te lajmi i kronikës së zezë. Krahas zhvillimeve sociale, arsye që lidhen direkt me problematikat e vetë tregut të medias, komunitetit të gazetarëve në Shqipëri apo modeleve të ndryshme të adoptuara nga mediat e vendeve fqinje, për mbulimin e aktualitetit përbëjnë grupin e dytë të arsyeve se përse kemi një përqendrim kaq të madh të lajmeve të kronikës në hapësirën tonë mediatike.

Pavarësisht hapësirës që ze kronika në informacionin e përcjellë nga mediat audiovizive, më i rëndësishëm mbetet fenomeni i gjuhës së përdorur në lajmet e kësaj natyre. Zhvillimet teknologjike ashtu siç kanë çuar në sakrifikimin e disa parimeve deontologjike dhe profesionale të profesionit të reporterit, kanë shtuar presionin e nxitur nga konkurrenca për lajmin e minutës, së fundit.

Nga ana tjetër tregu i pa stabilizuar i mediave audiovizive në vend, informaliteti, apo vullneti për të ndërtuar një kornizë vetërregulluese nga ana e gazetarëve, çon shpesh në përdorimin e një gjuhe të papërshtatshme për normat e gazetarisë. Gjuha e përdorur nga gazetarët në raste të caktuara, që mbart element paragjykses, të cilët mund të nxitin stereotipet për kategori të ndryshme të shoqërisë, apo në disa raste edhe urrejtje, përbën sot një nga sfidat më të rëndësishme për gazetarinë e kronikës në vendin tonë.

Dukurinë e gjuhës së urrejtjes e vërejmë si një dukuri që nxitet nga nevoja për të krijuar sensacion dhe për të përfituar më tepër vëmendje nga audiencat. Duke qenë e tillë në lajmet e kronikës, elementë të gjuhës së urrejtjes i vërejmë më tepër në titujt e lajmeve, apo në strishat që shoqërojnë kronikën në edicione informative në televizion.

Ndërkohë që një tjetër hapësirë brenda lajmeve të kronikës, ku mund të vihet re më tepër prania e gjuhës së urrejtjes, është intervistimi i të afërmëve të viktimave, apo personave të prekur nga ngjarje të rënda. Intervistat e këtyre personave që jepen si element pasurues i kronikës së lajmit, mbartin shpesh qasje emocionale dhe thirrje për vetëgjyqësi, të cilat përbëjnë një rast tipik të përcjelljes së gjuhës së urrejtjes nga mediat audiovizive.

Ky studim synon të marrë në analizë situatën e përdorimit të gjuhës së urrejtjes në median shqiptare, duke përdorur analizën e qasjeve teorike, analizën krahasimore dhe studimin e rasteve nga konteksti mediatik shqiptar. Fokusi i analizës është përdorimi i detajeve gjuhësore që nxisin stereotipe dhe urrejtje tek audiencat.

Fjalë kyçe: media, gjuha e urrejtjes, stereotipe, lajmi, kronika

PËRKUFIZIMI I GJUHËS SË URREJTJES



Erlis Çela

Studimi i gjuhës së urrejtjes në media, apo i detajeve që prodhojnë stereotipe dhe urrejtje të audience, është një angazhim me shkallë të lartë vështirësie, për disa arsye.

Së pari në realitetin e medias shqiptare, duket sikur mes gjithë problemeve dhe sfidave me të cilat përballen gazetarët apo vetë aktorët mediatikë, në një treg me shkallë të lartë informaliteti, me përqëndrim të lartë të pronësisë mediatike, dhe me një raport jo-transparent mes qendrave të pushtetit dhe vetë medias, gjuha e urrejtjes duket sikur mbetet jashtë vëmendjes.

Së dyti, koncepti në vetvete është i tillë që ndërthur disa disiplina studimore, që nga studimet juridike,

studimet sociale dhe ato të fushës së komunikimit. Është e qartë që gjuha e urrejtjes, në shumicën e rasteve ka një raport të dyfishtë me stereotipet. Nga ana tjetër stereotipet janë fenomen sa social aq edhe psikologjik që lidhet me formimin e qëndrimeve të individit në një kontekst të caktuar social.

Së treti, studimi i fenomenit në këndvështrimin e komunikimit dhe medias, është një përpjekje jo shumë e strukturuar. Kjo temë ka qënë ekskluzivitet i fushës së jurisprudencës për një kohë të gjatë.

Thomas Kent, përgjegjësi për standardet në Agjensinë e lajmeve “Associated Press”, në një artikull të publikuar në revistën, “Media Asia insight”, shprehet se gjuha e urrejtjes është një sfida për gazetarët e ditëve të sotme dhe se zgjidhja mund të vijë si rezultat i standardeve vetërregulluese të gazetarëve. Krahas elementëve vetërregullues, një rol të rëndësishëm në parandalimin e gjuhës së urrejtjes në lajmet e kronikës mund të japin edhe katedrat e shkollave të gazetarisë dhe komunikimit, si dhe qendrat trajnuese të gazetarëve që mbulojnë këtë sektor të informacionit.

Një nga përkufizimet më të cituara në lidhje me gjuhën e urrejtjes është bërë nga organizmat e Këshillit të Evropës. Më konkretisht, në Rekomandimin nr. R (97) 20 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për “gjuhën e urrejtjes” në vitin 1997. Në Shtojcën e Rekomandimit theksohet se nocioni “gjuha e urrejtjes” duhet të kuptohet si një nocion i cili i përfshin të gjitha format e të shprehurit me të cilat përhapet, nxitet, promovohet ose arsyetohet urrejtja racore, ksenofobia, antisemitizmi ose forma të tjera të urrejtjes, të bazuara mbi mostolerancë, përfshirë edhe: mostolerancën e shprehur në formë të nacionalizmit dhe etnocentrizmit agresiv, diskriminimin dhe armiqësinë ndaj minoriteteve, migrantëve dhe personave me origjinë imigrante.

Ndërkohë që edhe Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut, në çështje të ndryshme që ka shqyrtuar, i është referuar pikërisht këtij përkufizimi. Ndërkohë që studiuesit e fushës bien dakord që nuk ekziston një përkufizimi i unifikuar rreth këtij koncepti. Gjuha e urrejtjes është një lloj i të shprehurit që është projektuar të promovojë urrejtje në bazë të racës, religjionit, përkatësisë etnike, origjinës kombëtare, gjinisë, orientimit seksual, prejardhjes klasore/ sociale, pengesave trupore ose mendore. Me gjithë referencat e mësipërme, është e qartë se koncepti, ka evoluar me kalimin e kohës dhe si pasojë e realiteteve të reja të krijuara nga zhvillimet teknologjike.

Në një studim me titull “Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes” të publikuar në vitin 2013 nga Elena Mihajlova, Jasna Bačovska dhe Tome Shekerxhiev, krahas përkufizimit të konceptit, vihet theksi te format jo të drejtpërdrejta të përdorimit të kësaj lloj gjuhe. Sipas këtij studimi, përdorimi publik i simboleve, manifestimi i tyre eksplicit në parada, protesta, djegia e flamujve, etj, janë forma të tjera shprehjeje që përbajnë elementë të gjuhës së urrejtjes. *(Mihajlova, Bačovska and Shekerxhiev 2013)*

Ndonëse fillimisht debatet e para në lidhje me përdorimin e gjuhës së urrejtjes lindën pas luftës së dytë botërore, kryesisht për të adresuar tendencat antisemitike në diskursin publik dhe mediatik, zhvillimet teknologjike në fushën e komunikimit dhe informacionit, të dy dekadave të fundit e kanë bërë edhe më kompleks diskutimin e këtij fenomeni.

Autonomia që media sociale u ka ofruar përdoruesve në përzgjedhjen dhe konsumimin e informacionit, si dhe përdorimi i anonimatit si mburojë për fshehjen e autorësisë në publikimin e informacioneve të ndryshme, e kanë bërë të vështirë kontrollin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes në hapësirën informative në përgjithësi. Nga ana tjetër, termi “gjuhë e urrejtjes” në vetvete ka evoluar, duke u ndërlidhur me koncepte të ngjashme dhe duke u bërë më i vështirë për t’u identifikuar dhe parandaluar. Ndërkohë edhe perceptimi i

audienceve për gjuhën e urrejtjes, ka evoluar paralelisht me ndryshimet e lart përmendura. Vihet re që vëmendja e audienceve ndaj çështjeve temave të tilla, varet më së shumti nga hapësira që merr debati për to në hapësirën mediatike.

Për ta ilustruar këtë mund të përmendin rastin e vëmendjes që po merr diskutimi për “lajmet e rreme” (fake news). Megjithëse lajmet e rreme, të qëllimshme ose jo, kanë ekzistuar që nga fillimet e formave të para të shtypit, ky fenomen ka marrë vëmendje të madhe që pas zgjedhjes së Donald Trump si president i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Përplasja e tij me mediat konvencionale dhe hapësira që ky debat ze në ekranet televizive, ka ndikuar në perceptimin e audienceve në këtë vend. Një studim i bërë nga “First Amendment Center of the Freedom Forum Institute” zbuloi se amerikanët e konsiderojnë lajmin e rremë (fake news) më të papranueshëm në krahasim me gjuhën e urrejtjes. (Institute 2018) Ndonëse në Shqipëri nuk ka studime për të matur vëmendjen që audiencat u kushtojnë këtyre dy fenomeneve, nuk është e pavend të hamendësohet se “fake news”, për shkak të përdorimit të shpeshtë në diskursin publik dhe mediatik, është në qendër të vëmendjes

Qasje të ndryshme studimore dhe korniza teorike

Gjuha e urrejtjes si fushë studimi ka qenë, për shumë dekada, ekskluzivitet i studimeve juridike, duke e parë problemin nga fokusi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kjo është edhe arsyeja kryesore se përse në shumë studime, që kanë në fokus këtë temë, literatura e përdorur i referohet akteve ndërkombëtare që garantojnë të drejtat e njeriut. Nëse i referohemi kontekstit shqiptar të studimit të gjuhës së urrejtjes, dalim në të njëjtin përfundim. Referencat e para për këtë fenomen, i gjejmë në Kushtetutën e Shqipërisë dhe në Kodin Penal. Në rastin e Kushtetutës, neni 22 që i referohet lirisë së shprehjes. Ndërsa neni 256 i Kodit Penal rregullon çështjet e “Nxitjes së urrejtjes ose grindjeve” dhe bën një përkufizim të këtyre krimeve. Ndërkohë fenomeni, dhe impakti që ai ka në ditët e sotme, e bën të domosdoshëm këndvështrimin që sjell komunikimi mbi këtë fenomen.

Një nga autorët që është përpjekur të ndërtojë një kornizë teorike për studimin e këtij fenomeni nga këndvështrimi i teorive të komunikimit, është Clay Calvert nga “Pennsylvania State University”. Në studimin e tij me titull “Gjuha e urrejtjes dhe dëmet e saj: një perspektivë e teorisë së komunikimit” të publikuar në “Journal of Communication”, ai përpiket ta analizojë këtë koncept bazuar në modelet e komunikimit të autorit amerikan “James Carey”. Sipas Calvert modeli transmetues i komunikimit dhe modeli ritual i komunikimit, përbëjnë një bazë të mirë për të ndërtuar një analizë rreth konceptit të gjuhës së urrejtjes dhe dëmeve që shkatton mbi audiencat. (Calvert 1997)

Ai argumenton se çdo rast i dëmit të shkaktuar nga gjuha e urrejtjes përfshin domosdoshmërisht katër elementë bazë të modeleve të hershëm të komunikimit. Kështu kur kemi të bëjmë me përdorim të gjuhës së urrejtjes në media, kemi burimin (komunikues i gjuhës së urrejtjes), mesazhin (fjalët ose simbolet e urrejtjes), kanalin (rrugë apo mjete përmes të cilit mesazhi përcillet), dhe një marrës (publiku ose objektivi i mesazhit me përmbajtje urrejtjeje). Modeli i transmetimit të komunikimit, përfaqësues i traditës së hulumtimit të efekteve të komunikimit, fokusohet në “bindjen; ndryshimin e qëndrimit dhe modifikimin e sjelljes “shkaktuar nga gjuha. (Calvert 1997)

Ndërkohë që bazuar në modelin ritual të komunikimit theksi vihet te mbajtja e një realiteti të nënshtrimit dhe diskriminimit ndaj pakicave racore dhe etnike, të cilat mund të jenë pre e kësaj gjuhe. Përdorimi ritual i epiteteve raciste që përmban gjuha e urrejtjes, lehtëson dhe promovon trajtim të diferencuar dhe të pabarabartë të grupeve të veçanta.

Për të kuptuar më mirë fenomenin kompleks të gjuhës së urrejtjes, krahasimi me konceptet e tjera të ngjashme mund të jetë një metodë e vlefshme. Studiues të ndryshëm janë ndalur në dallimin mes konceptit të gjuhës së urrejtjes dhe koncepteve të ngjashme që lidhen ose ndikohen nga ky fenomen. Duhet të pranojmë faktin se vëmendja e shtuar ndaj përdorimit të kësaj forme të gjuhës në media, ka bërë që koncepti të shoqërohet me koncepte të ngjashme që kanë lidhje me të, ose që ndikohen nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes.

Një studim i realizuar nga Paula Fortuna dhe Sérgio Nunes, dy studiues të Universitetit të Portos, në korrik të këtij vitit, i publikuar në revistën shkencore, “ACM Computing Surveys”, ka zbuluar se koncepti i “hate speech” shoqërohet shpesh me koncepte të tjera si “urrejtja”, “cyberbulling” ose “bullizmi kibernetik”, “diskriminimi”, “gjuhë abuzuese”, “ekstremizmi”, “radikalizmi”, “gjuhë toksike”, etj. (Fortuna and Nunes July 2018) Shpesh këto terma ngatërrohen me njëra tjetrën duke krijuar një konfuzion si për profesionistët e medias ashtu edhe për vetë studiuesit e këtij fenomeni. Për të dy studiuesit e lartpërmendur, identifikimi i dallimeve që ka “gjuha e urrejtjes” dhe konceptet e ngjashme, përbën pikën fillestare nga ku duhet të nisë adresimi i problemit. (Nobata, et al. 2016)

Në rastin e diskursit mediatik, ne vëmë re se fjalë që mund të klasifikohen në kategorinë “gjuhë e urrejtjes” ndaj një grupi të caktuar, në fakt përbëjnë elementë të diskriminimit. Diskriminimi është procesi përmes të cilit identifikohen dallimet mes grupeve apo individëve të ndryshëm, të cilat me pas, përdoren si bazë e padrejtësisë në trajtim. Ndërkohë që gjuha e urrejtjes përbën një nga format e diskriminimit që shkaktohet nëpërmjet komunikimit verbal. Ndërsa në

rastin e ekstremizmit, Fortuna dhe Nones shprehen se në diskursin ekstremist përdoret shpesh gjuha e urrejtjes, por përqëndrimi është edhe në tema të tjera si bindja, rekrutimi i anëtarëve të rinj, si dhe indoktrinimi.

Detaje që nxisin stereotipe në lajmet e kronikës

Në ditët e sotme, përdorimi i gjuhës së urrejtjes nga ana e mediave është një temë e debatueshme në shumë vende të ndryshme. Gazetarët dhe mediat e shikojnë fenomenin nga këndvështrimi i burimit të gjuhës së urrejtjes. Ky këndvështrim vendos në qendër të akuzës si burim i gjuhës së urrejtjes, politikën dhe diskursin publik të politikanëve. Në kontekstin shqiptar duket se kjo qasje gjen vend edhe më tepër duke patur parasysh, diskursin publik të politikanëve, të cilët në mjaft rast i tejkalojnë çdo normë etike të komunikimit publik, duke përfshirë në ligjëratat e tyre, elementë të urrejtjes, gjuhë diskriminuese apo edhe fyerje nga më të rëndomtë. Pra gjuha e urrejtjes që ne hasin në media, sipas këndvështrimit të gazetarëve, vjen si një zgjedhje e detyruar, për shkak të pasqyrit të mediat i bëjnë aktualitetit dhe zhvillimeve në vend. Në pamje të parë kjo perspektivë duket se krijon një kornizë justifikuese për vetë profesionistët e medias, të cilët e delegojnë përgjegjësinë të burimi i cituar në lajm.

Një situatë të ngjashme e shohim edhe në lajmet e kronikës. Duhet thënë se, ashtu si në rastet e politikës edhe në ato të kronikës qëndrimi i gazetarëve në përgjithësi, nuk reflekton përdorime të qëllimshme të gjuhës së urrejtjes. Gazetarët janë të vetëdijshëm në mospërdorimin e fjalëve që mund të cenojnë integritetin, personalitetin, apo përkatësitë e ndryshme të grupeve të caktuara.

Një monitorim me titull “Prijet e gjuhës së urrejtjes në median shqiptare” i kryer nga Instituti Shqiptar i Medias dhe Fondacioni për Shoqëri të Hapur, ka evidentuar si tipar karakterizues të shtypit shqiptar, sensacionin në titujt e lajmeve të kronikës. (Instituti Shqiptar i Medias 2015) Ndërkohë që sipas të njëjtit monitorim vihet theksi në gjuhën e sjellë në ekran apo në faqet e gazetave, nëpërmjet intervistimit të të afërmeve të viktimave apo personave të përfshirë në ngjarje kriminale. Për nga vetë konteksti në të cilën ndodhen personat e intervistuar, është e natyrshme që në gjuhën e përdorur nga ata, të këtë dozë të fortë emocioni, ndjenjë hakmarrjeje dhe gjuhë urrejtje. Në këtë rast, reporteri vihet përpara dilemës etike nëse duhet ta përfshijë në lajm, një gjuhë të tillë apo duhet të përdorë perifrazimin dhe të përcjellë citimin me fjali të përgjithshme.

Në kuadër të pasqyrit të gjuhës së urrejtjes përmes citimeve apo intervistave të përfshira në lajmet e kronikës, si rast për tu analizuar mund të merret lajmi

i cili referohet urdhërit të zv.ministrit të brendshëm Sandër Lleshi. Titulli i lajmit në televizionin Ora News ishte *“Çudit Sandër Lleshi: Policët ‘bark derra’, shërbim vetëm në vende të padukshme”*. Nëse i referohemi përkufizimit të mësipërm ku një nga elementët që targeton gjuha e urrejtjes konsiderohen edhe “pengesa trupore ose mendore”, atëherë pasqyrimi i lajmit me këtë titull ku vihet theksi te një anomali e peshës së trupit, të punonjësve të policisë, është një shembull që mund të klasifikohet si formë e përdorimit të gjuhës së urrejtjes në lajmet e kronikës.

Një tjetër rast i përdorimit të gjuhës së urrejtjes në lajmet e kronikës është ai i lajmit që i referohet rastit të një vajze nga një fshat i Fushë Krujës, e cila u përfshi në një sërë lajmesh të medias për marrëdhënien e saj me djalin e një deputeti. Në lajmin e pasqyruar nga gazeta “Mapo” në datën 27 shtator 2018, me titull *“Flet Xhisiela Maloku: Djali i deputetit më dogji me cigare, humba ndjenjat”*, mund të identifikojmë përdorimin e fjalëve të cituara që përmbajnë elementë të dhunës verbale dhe urrejtjes. Ashtu si në rastet e tjera, edhe në këtë lajm, kemi përfshirjen e gjuhës së urrejtjes në lajm, nëpërmjet zërit të cituar. Në këtë rast, nëpërmjet titullit, është synuar të rritet shkalla e sensacionit, për të tërhequr me shumë vëmendjen e lexuesve.

Dilema mes vetërregullimit dhe ndërhyjes shtetërore

Sa herë që shtrohen për diskutim çështje që kanë të bëjnë me etikën në media apo vlera profesionale të gazetarisë, dilema më e madhe është nëse, vetërregullimi është i mjaftueshëm apo duhet ndërhyrje rregullatore nga aktorë të jashtëm. Nëse i referohemi qëndrimit të komunitetit të gazetarëve, dhe profesionistëve të medias, në shumë raste ajo anon nga ideja e vetërregullimit si një mekanizëm shterues për zgjidhjen e problemit.

Ky qëndrim mbështetet më tepër në parimin se gazetarët dhe mediat nëpërmjet vetërregullimit mund të ruajnë balancën mes lirisë së shprehjes dhe shmangies së gjuhës së urrejtjes. Nga ana tjetër, në media mund të evidentohen mjaftueshëm situata ku mekanizmi i vetërregullimit nuk ka qenë i mjaftueshëm për të adresuar problemin. Në këto raste shihet si zgjidhje ndërhyja e mekanizmave shtetërore, apo organizma rregullatore të pavarura, të cilët nëpërmjet normave ligjore dhe rregullatore, të lidhura me masa ndëshkuese, mund të ndikojnë në parandalimin e fenomeneve të tilla në diskursin mediatik.

Praktikat vetë-rregulluese të medias janë testuar në realitete të ndryshme të tregut mediatik duke krijuar një traditë në deontologjinë e profesionit. Sipas studiueses Amanda Lotz nga Universiteti i University of Michigan këto praktika

mund t'i japin përgjigje shqetësimit të publikut për respektimin e parimeve etike dhe shmangjen e gjuhës së urrejtjes, pa i hapur rrugë një mbikëqyrjeje formale qeveritare. Lotz argumenton se kjo qasje vetë-rregulluese i shkon për shtat të gjitha palëve. (Lotz 2018) Së pari, institucionet qeveritare çlirohen nga ideja se po ndërhyjnë në media duke ndikuar negativisht në të drejtën e lirisë së shprehjes dhe lirisë së shtypit. Së dyti, media arrin të shmangë kufizimet formale dhe detyrimet që mund të vijnë nga ndërhyrja shtetërore, të cilat mund prodhonin një barrë të rëndë për të. Së treti, publiku ndjehet i vlerësuar si rezultat i marrjes në konsideratë i shqetësimeve që ka ndaj medias në lidhje me përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe formave të tjera diskriminuese.

Lotz sjell si rast ilustrues zgjidhjen që i dhanë televizionet amerikane shqetësimit të ngritur për rritjen e skenave me përmbajtje seksuale dhe skenave të dhunës rreth viteve 1970. Për t'i dhënë zgjidhje problematikës së krijuar, rrjetet televizive ranë dakord të krijojnë të ashtuquajturën “Ora familjare”, e cila ishte përcaktuar në orën e parë të “prime time”. Synimi ishte për të krijuar një fashë orari “të pastër” për publikun. Monitorimi për këtë orar u mor përsipër nga *Shoqata Kombëtare e Transmetuesve* dhe jo nga ndonjë mekanizëm shtetëror.

Përfundime dhe rekomandime

Gjuha e urrejtjes në të gjitha format që ajo shfaqet në media, përbën një rrezik që duhet marrë në konsideratë për t'u parandaluar. Media, pavararësisht transformimeve teknologjike që kanë ndodhur në dekadat e fundit mbart ende një rol të rëndësishëm në percjelljen e informacionit, orientimin e audiencave dhe strukturimin e agjendës publike. Nisur nga ky vlerësim mund të thuhet se media kontribuon jo vetëm në përhapjen e gjuhës së urrejtjes te audiencat por edhe në amplifikimin e ndikimit që ky fenomen mund të ketë në gjithë shoqërinë.

Pavarësisht se në pamje të parë duket sikur problematika qëndron në përdorimin e kësaj lloji gjuhe nga reporterët gjatë punës së tyre, zgjidhja e problemit nuk mund të shihet vetëm në kontekstin e rritjes së ndërgjegjes profesionale të gazetarëve. Fenomeni i përdorimit të gjuhës së urrejtjes në median shqiptare, dhe veçanërisht në lajmet e kronikës, kërkon një kombinim komponentësh që mund të përfshihen në zgjidhje. Së pari, është e rëndësishme të forcohen mekanizmet vetërregullues të medias. Në këtë pikë duhet thënë se nuk është e mjaftueshme vetëm të shkruhen kodet që përcaktojnë rregullat dhe masat për parandalimin e këtij fenomeni, por njëkohësisht duhet që të shtohen përpjekjet edhe për njohjen e gazetarëve me këto mekanizma. Pjesë e rëndësishme e kësaj qasjeje të integruar të zgjidhjes, duhet të jenë edhe

shkollat e gazetarisë në vend, të cilat mund të kontribuojnë në edukimin e gazetarëve të rinj.

Më konkretisht, duhet që në kurrikulat e reja të shkollave të gazetarisë të shtohen lëndë për komunikimin ndërkulturor, semitokën e lajmit, si dhe të zgjerohet spektri i temave që trajtohen në kuadër të lëndës së etikës. Një pikë e rëndësishme ka të bëjë me angazhimin e strukturave redaksionale në këtë proces. Zgjidhja nuk duhet të kërkohet vetëm në kuadër të kodeve që prodhojnë organizatat profesionale apo autoritetet rregullatore siç është rasti i AMA-s. Është e nevojshme që ndërgjegjësimi të nisë nga brenda redaksive, kur politikat editoriale, përsa i përket këtij fenomeni, të jenë të qarta dhe t'u bëhen të ditur gazetarëve që nga momenti që ata përfshihen në këtë profesion.

Bibliografia

Calvert, Clay. 1997. "Hate Speech and Its Harms: A Communication Theory Perspective." *Journal of Communication* 47(1).

Erjavec, Karmen, and Melita Poler Kovac̃ic. 2012. "You Don't Understand, This is a New War!" Analysis of Hate Speech in News Web Sites' Comments." *Mass Communication and Society* 899–920.

Fortuna, Paula, and Sérgio Nunes. July 2018. "A Survey on Automatic Detection of Hate Speech in Text." *ACM Computing Surveys, Vol. 51, No. 4*.

Institute, Freedom Forum. 2018. www.freedomforuminstitute.org. June 28. Accessed July 30, 2018. https://www.freedomforuminstitute.org/wp-content/uploads/2018/06/2018_FFI_SOFA_Report.pdf.

Instituti Shqiptar i Medias, OFSA. 2015. *Prirjet e gjuhës së urrejtjes në median shqiptare. Një monitorim i disa mediave të shkruara dhe online*. Tirane: Instituti Shqiptar i Medias.

Lotz, Amanda. 2018. *theconversation.com*. August 8. Accessed November 1, 2018. <https://theconversation.com/profit-not-free-speech-governs-media-companies-decisions-on-controversy-101292>.

Mihajlllova, Elena, Jasna Baçovska, and Tome Shekerxhiev. 2013. *Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes*. Shkup: OSBE.

Nobata, Chikashi, Joel Tetreault, Achint Thomas, Yashar Mehdad, and Yi Chang. 2016 . "Abusive Language Detection in Online User Content." *Proceedings of the 25th International Conference on World Wide Web*. Montréal, Québec, Canada — April 11 - 15, 2016 : International World Wide Web Conferences Steering Committee . 145-153 .

PÖYHTÄRI, Reeta. 2014. "Limits of hate speech and freedom of speech on moderated news websites in finland, sweden,the netherlands and the uk." *ANNALES* 513-524.

Shqipërisë, Kuvendi i Republikës së. 2016. *Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. Neni 256*. Tirane.

Taylor, Robert S. 2012. "Hate Speech, the Priority of Liberty, and the Temptations of Nonideal Theory." *Ethic Theory Moral Prac* 353–368.

Yong, Caleb. 2011. "Does Freedom of Speech Include Hate Speech?" *Res Publica* 385–403.

References

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut. 1948. (Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 10 Dhjetor).

Drożdż, Michał. T. 35 (2016) nr 5. «Hate Speech in Media Discourse.» *Acta Universitatis Lodziensis. Folia Litteraria Polonica* 20-30.

Fortuna, Paula, dhe Sérgio Nunes. 2018. «A Survey on Automatic Detection of Hate Speech in Text.» *ACM Computing Surveys*. doi:<https://doi.org/10.1145/3232676>.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. 2016. (Kuvendi i Republikës së Shqipërisë).

Mihajllova, Elena, Jasna Bačovska, dhe Tome Shekerxhiev. 2013. *Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes*. Shkup: Polyesterday.